REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.119.Datë 24.12.2025

PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË VLERËSIMIT TË RISKUT NGA FATKEQËSITË PËR VITET 2025-2030.

Këshilli në mbledhjes e dates së mësipërme,bazuar në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

VENDOSI

15 VOTA PRO

0 KUNDRA

0 ABSTENIM

1.Të miratojë planin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë për vitet 2025-2030 sipas Projekt Vendimit.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak.

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore,".

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Isuf SEFOLLI

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE
EMERGJENCA CIVILE

Nr.454/ Prot. Krumë, me 12/12/2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. 01 Datë 12.12.2025

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015, "Per Vetëqeverisjen Vendore", ligjin Nr.45/2019 "Per mbrojtjen civile", VKM Nr. 807, datë 28.12.2023 "Për Miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile", VKM Nr. 168, datë 24.3.2023, "Për Miratimin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror", VKM nr. 94, datë 22.2.2023, "Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe planit të veprimit", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, i kërkojmë Këshillit Bashkiak, të;

MIRATOJË:

- Planin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Bashkisë Has, për vitet 2025-2030.
- Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet e gjithë struktura e Bashkisë Has.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Drejtoresha e Mbrojtjes Civile
Arbërie Rada

Përgj. e Sektorit Juridik
Erisa Ferizolli

Përgj. i Emergjencave Civile
Fatos Ahmati

KRYETARI

Miftar DAUTI

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE
EMERGJENCAT CIVILE

Nr 4541/1 Prot. Krumë, me 12/12/2025

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK HAS
PËR

Miratimin e Planit të Strategjisë Vendore të Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Bashkinë Has për vitin 2025-2030.

Të nderuar Këshilltarë,

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", Ligjit Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", Vendimi Nr. 168 datë 24.03.2023 "Për Miratimin dhe Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror".

Ju informojmë:

Strategjia vendore e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë ka të bëje me zbatimin e politikave dhe strategjive për zvogëlimin e riskut të fgatkeqësive, për të parandaluar riskun e ri, për të zvogëluar riskun egzistues dhe për të menaxhuar riskun e mbetur, duke ndihmuar në forcimin e vetpërtëritjes dhe zvogëlimin e humbjeve në rast fatkeqësie.

Në këtë dokument bëhet një analizë për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e riskut nëpërmjet analizës të risqeve të mundshme dhe vlerësimit të kushteve egzistuese të ekspozimit dhe cënueshmërisë, që së bashku mund të dëmtonin njerëzit , pronën, shërbimet, jetesën dhe mjedisin e ekspozuar nga i cili ato varen.

Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë është një proces ligjerisht i parashikuar dhe planifikues që synon të identifikojë, analizojë dhe vlerësojë rreziqet potenciale natyrore që mund të ndikojnë në jetën, shëndetin, pronën, infrastrukturën dhe mjedisin në territorin e Bashkisë Has. Sipas legjislacionit në fuqi, ky vlerësim përfshin identifikimin e llojeve të rreziqeve, karakteristikave dhe shkaktarëve të tyre, nivelin e ekspozimit dhe cenueshmërisë së popullsisë dhe aseteve komunale, si dhe pasojat e mundshme për komunitetin dhe mjedisin.

Qëllimi kryesor është hartimi dhe miratimi i dokumenteve të vlerësimit të riskut për të mbështetur dhe lehtësuar punën e institucioneve qendrore dhe vendore në zhvillimin e një strategjie koherente dhe gjithëpërfshirëse për menaxhimin dhe zvogëlimin e riskut të fatkeqësive si dhe forcimin e të gjithë sistemit të mbrojtjes civile në vend.

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

Hartimi i tij synon të japë njohuri në shumë drejtime rreth proçeseve të bashkëpunimit të aktorëve të ndryshëm vendor dhe kombëtar, përfshirë dhe aktorët ndërkombëtar ndërveprues në territor në interes të mbrojtjes civile.

Pikat kryesore të përfshira në këtë plan, si më poshtë vijon:

-Rreziqet nga dëbora.
-Rreziqet nga zjarret.
-Rreziqet nga rrëshqitjet e tokës.
-Përmbytjet.
-Rreziqet sizmike .
-Rreziqet nga aktet terorriste.
-Epidemi të ndryshme.
-Ngjarje të mundshme rrezikuese teknologjike.

Ky miratim do të mundësojë zbatimin e masave të parandalimit, përgatitjen e strukturave vendore dhe krijimin e një kuadri planifikues të sigurt për menaxhimin e emergjencave në territor.

Përgjegjësi i Emergjencave Civile

Fatos Ahmati

Sektori Juridik

Erisa FERIZOLLI

Drejtoresha e Mbrojtjes Civile

Arbërie Rada

KRYETARI

Miftar DAUTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

MIRATOHET


KRYETARI

MIFTAR DAUTI

Nr.4523 Prot.

Krumë, më 12 / 12 /2025

PLANI I VLERËSIMIT TË RISKUT NGA FATKEQËSITË NË BASHKINË HAS



Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

Përmbledhje

" Plani për Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë, është dokumenti kryesor i politikave të Strukturave Shtetërore në fushën e mbrojtjes civile".

Në kushtet kur ekziston një bazë ligjore, një strukturë në ngritje e përmirësim dhe ku burimet shtetërore janë të kufizuara, planifikimi i përdorimit të kapaciteteve, ndarja mirë e përgjegjësive, identifikimi i boshllëqeve dhe shmangia e mbivendosjeve është mjaft e nevojshme. Këto kërkesa bëhen realitet nëpërmjet Vleresimit te riskut i cili afron mundësi për menaxhimi efektiv, të strukturave shtetërore dhe jo shtetërore për përballimin e emergjencave civile.

Plani i Vleresimit të Riskut duhet të shihet si një dokument praktik i hartuar nëpërmjet një proçesi të gjatë konsultimesh dhe planifikimi të përbashkët me një numër të gjerë institucionesh qeveritare dhe joqeveritare, për t'a mbajtur planin koherent dhe të freskuar me informacion të ri në mënyrë të vazhdueshme, aktual e të lidhur me ndryshimet e ambientit shqiptar, për të arritur qëllimin për të cilin është hartuar, mbrojtjen e popullsisë, pronës dhe trashëgimisë kulturore nga emergjencat civile.

Është e rëndesishme të theksohet se Plani i Vleresimit të Riskut është një burim praktik i përdorshëm, për të gjitha fazat e ciklit të emergjencave, duke filluar nga parapërgatitja, përgjigja e duke vazhduar më tej në fazën e rikthimit në gjendjen normale dhe lehtësimin e pasojave. Për arsye se Plani i Vleresimit të Riskut është hartuar vetë nga protagonistët pjesmarrës, ai është pronë e të gjitha strukturave shteterore, Njësive Administrative, të gjitha organizatave shtetërore dhe të shoqërisë civile, institucioneve, organizatave vullnetare dhe e publikut të gjerë.

Ai është një dokument, i cili reflekton eksperiencën për një sërë dukurish të mundshme rreziku, kapacitetet dhe vështirësitë në përballimin e emergjencave civile në Bashkinë Has.

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

PËRMBAJTJA

Përmbledhje Ekzekutive

Përmbajtja

Shkurtime

1. Hyrje.

1.1 Pozicioni Gjeografik.

2. Historiku.

3. Qëllimi dhe objektivat.

4. Mbledhja e të dhënave për vlerësimin e riskut.

4.1 Popullsia.

4.2 Banesat, Monumentet Kulturore.

4.3 Infrastruktura kritike dhe Publike.

4.3.1 Rrjeti rrugor .

4.3.2 Rrjetet e kullimit/ujitjes.

4.3.3 Linjat elektrike.

4.4 Tokë bujqësore.

5. Metodologjia.

6. Konteksti i Vleresimit të Riskut.

7.Kuadri ligjor dhe institucional për vleresimin e riskut dhe mbrojtjen civile.

8. Përmbledhje e rreziqeve kryesore në Bashkinë Has.

8.1 Rreziku i përmbytjeve.

8.2 Rreziku nga zjarret.

8.3 Rreziku teknologjik.

8.4 Rreziku nga aktivitetet sizmike.

8.5 Rrëshqitja e tokës.

8.6 Rreziqet nga dëbora.

8.7 Digat dhe rreziqet.

8.8 Rreziku Biologjik.

9. Ndarja e secilit Risk me të dhëna demografike dhe Territoriale.

9.1 Risku nga Tërmeti.

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

9.2 Risku nga rrëshqitjet e tokës.

9.3 Risku nga zjarret.

9.4 Risku nga përmbytjet.

9.5 Risku nga orteku/bora.

9.6 Risku biologjik.

9.7 Risku nga çarja e digave.

9.8 Risku teknologjik.

10. Analiza e risqeve të shumëfishta për rreziqet kryesore në Njësitë Administrative të Bashkisë Has.

10.1 Risku nga fatkeqësitë, Njesia Administrative Krumë.

10.2 Risku nga fatkeqësitë, Njesia Administrative Golaj.

10.3 Risku nga fatkeqësitë, Njesia Administrative Gjinaj.

10.4 Risku nga fatkeqësitë, Njesia Administrative Fajza.

11. Qëllimi i raportit të konsoliduar për riskun nga fatkeqësitë në Shqipëri.

11.1. Qasja e vlerësimit të rreziqeve të shumëfishta dhe risqeve të shumëfishta.

11.2 Kufizimet e metodologjisë.

12. Grupet kryesore të interesit.

13. Përmbledhje e rekomandimeve kryesore.

13.1 Zbutja e riskut nga fatkeqësitë.

13.2 Ngritja e kapaciteteve për vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë.

13.3 Hartimi i Strategjisë për MRF.

14. Figurat.

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

Lista e Shkurtime

SMF	- Sistemi i Menaxhimit të Fatkeqësive
KVMC	- Komisioni Vendor i Mbrojtjes Civile
KM	- Këshilli i Ministrave
MB	- Ministria e Brendshme
MM	- Ministria e Mbrojtjes
MSH	- Ministria e Shëndetësisë
OJQ	- Organizatë Jo Qeveritare
PKMC	- Plani Kombëtar i Mbrojtjes Civile
PPKMCQ	- Plani i Përballimit dhe Koordinimit të Mbrojtjes Civile në Qark
RRF	- Reduktimi i Rrezikut të Fatkeqësive
QO	- Qendrat Operative
KKSH	- Kryqi i Kuq Shqiptar
AEB	- Agjencia Ekstensionit Bujqësor
AKU veterinare).	- Autoriteti Kombetar i Ushqimit (Kontrollin e produkteve ushqimores herbimet
ARRSHRQ	- Autoriteti Rrugor Shqiptar, Rajoni Qendror.
NJVKSH	- Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
ISHSH	- Inspektorit Shtetëror Shëndetësor
SHF	- Shërbimi Farmaceutik etj.
DVPSH	- Drejtoria Vendore e Policisë së Shtetit
OSHEE	- Operatori i Shperndarjes së Energjisë Elektrike
ZA	- Zyra Arsimore
SDMMCK	- Struktrurat e Drejtimit dhe të Menaxhimit të Mbrojtjes Civile dhe Krizave
KKECK	- Komiteti i Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Krizave
ZOS	- Zyra Operacionale e Situatës
KTK	- Komisioni Teknik Këshillimor
ZIMMCK	- Zyrat e Informacionit dhe Menaxhimit të Mbrojtjes Civile dhe Krizave
DPPSH	- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPRMSH	- Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit
DPMZSH	- Drejtoria e Policisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin
IKMT	- Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
ARRSH	- Autoriteti Rrugor Shqiptar
DPD	- Drejtoria e Përgjithshme Detare
DPUK	- Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve
AAC	- Autoriteti i Aviacionit Civil
IFBZ	- Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar
SHGJSH	-Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
AKB	-Agjensia Kombëtare Bërthamore
RISHM	-Reparti Inspektim dhe Shpëtim Minierave
AEB	-Agjencia e Ekstensionit Bujqësor

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

DRU	-Drejtoria Rajonale e Ujrave
AKU	-Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
ISUV	-Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare
AKT	-Agjensia Kombëtare e Turizmit
AKB	-Agjensia Kombëtare e Bregdetit
ISHP	-Instituti i Shëndetit Publik
ZMR	-Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet
ARM	-Agjensia Rajonale Mjedisore
AKZM	-Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
AUB	-Agjensitë e Ujit dhe Baseneve
QNOD	-Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare
DPB	-Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
IGJEUM	-Instituti i Gjeoshkencave,Energjisë,Ujit dhe Mjedisit
RRF	-Reduktimi i Rriskut të Fatkeqësive

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

1.HYRJE

Rrethi Has shtrihet në pjesën Veri-Lindore të Republikës së Shqipërisë. Ka një sipërfaqe prej **399.62 km2** e popullsi **22,987 banorë**.
Bashkia përbëhet nga 4 njësi administrative:

- Krumë
- Golaj
- Gjinaj
- Fajza.

Rrethi i Hasit shtrihet ne Veri-Lindje te Shqiperise dhe ne kufi me Kosovën.
Ndodhet në një lartësi prej 370-450m mbi nivelin e detit.
Brenda territorit të vendit kufizohet me Qarkun e Kukësit dhe Rrethin e Tropojes.
Ekonomia e Hasit është e zhvilluar në disa degë si: bujqësia, blegtoria, peshkimi, turizmi, transporti etj. Ekonomia ka lëvizur nga bujqësia drejt ndërtimit, industrisë dhe shërbimeve. Ka shumë pak subjekte të mëdha private në rajon. Shumica e bizneseve kanë më pak se 7 punonjës pjesa më e madhe e të cilave drejtohen nga një person ose janë biznese familjare.
Sektorët ekonomike prioritarë dhe me potencial të rëndësishëm zhvillimi, rritje ekonomike dhe punësimi janë: turizmi, sektori minerar dhe bimët medicinale. Hasi ka asete të mjaftueshme për të tërhequr turistët, veçanërisht burimet natyrore të maleve, kullotat alpine, luginat e thella.
Për sa i përket performancës ekonomike, Hasi është konsideruar gjithmonë si një ndër rajonet më të varfëra të vendit.

1.1 Pozicioni Gjeografik




Fig. 1

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

2.Historiku

Rrethi i Hasit ashtu si vet pozicioni i vendit tonë shtrihet në brezin sizmik, alpin-mesdhetar,që përfshin zonën e kontaktit ndërmjet pllakave litosferike të Afrikës e të Euroazisë,e cila shtrihet nga ishujt Azore deri në kufirin lindor të pellgut të Mesdheut.

Rrethi i Hasit është shtrirë në zonat e ashtuquajtura "mesatare" për sa i përket intensitetit të termeteve. Shkalla e instensitetit është 6 deri në 7 ballë. Origjina e tërmeteve në Rrethin tonë është e karakterit tektonik. Faktorët që ndikojnë në intensitetin e tërmeteve është edhe fortësia e shkëmbinnjve. Kemi tre lloje shkëmbinjsh me forcë të lartë, mesatare e të ulët.

Rrethi i Hasit ka shkëmbinj me forcë relativisht të lartë dhe të ulët që përfaqësohen nga mbulesat e aluvioneve dhe deluvioneve. Intensiteti i tërmeteve me veprat inxhinierike që janë ndërtuar në shkëmbinj të fortë është më i vogel se në veprat inxhinierike që janë ndërtuar mbi veprat e aluvioneve dhe deluvioneve. Rrethi i Hasit është goditur nga tërmetet në viete 1967, 1979, 1998 në fund të vitit 2004.

Rrethi i Hasit u godit gjatë vitit 2019 datë 21.09.2019 e 26.11.2019 , ku kryesisht ka patur dëme në objekte ndërtimi. Sipas informacioneve të ardhura nga Njesitë Administrative ishin rreth 216 shtëpi banimi të dëmtuara dhe 1 objekte social kulturor i dëmtuar.

Vlerësimi i rrezikut nga tërmetet është realizuar për periudha përsëritje 50,100,200,475 dhe 1000 vjet.
Nxitimi maksimal i pritshëm i truallit (NMT-në % të g).g= 9.81 cm/s sipas periudhës karakteristike të përsëritjes.

Skenari	Burimi sizmik	PP-50	PP-100	PP200	PP-475	PP-1000	max
TSK-13	Hasi		14.0	20.3	28.2	52.8	5.7

Përdorimi i hartës aktuale të zonimit sizmik është përcaktuar për projektimin e ndërtesave të zakonshme, aktualisht për vepra të rëndësishme dhe objekte të larta është detyrim ligjor të bëhen studime të detajuara inxhiniero –sizmiologjike për të nxjerrë të dhëna konkrete në lidhje me rrezikun sizmik për sheshe konkrete ndërtimi.
Nëpërmjet studimit"Vlerësimi i Rreziqeve në Shqipëri" është realizuar për herë të parë vlerësimi tërësor i elementeve të domosdoshme për nevoja planifikimi dhe menaxhimi të emergjencave shkaktuar nga tërmetet.

Përmbytjet janë një ndër fatkeqësitë natyrore që ndodhin më rrallë në teritorin e Bashkisë Has . Pozicioni gjeografik i teritorit të Bashkisë Has bënë që fenomeni i përmbytjes të jetë shumë i rallë duke përjashtuar Fshatin Pla, Njesia Administrative Krumë.

Rreziku nga zjarret masive është klasifikuar si i lartë, çka do të thotë se ekziston një probabilitet më i lartë se 50% që vendi të përballet me një mot që mund të mbështesë një zjarr masiv, i cili ka gjasa të shkaktojë dëme të mëdha në pyje dhe kullota. Dëmet nga zjarret masive mund të ndodhin jo vetëm si pasojë e flakës së drejtpërdrejtë dhe ekspozimit nga rrezatimi por gjithashtu edhe si pasojë e stuhive që transportojnë materiale që digjen dhe e zjarreve sipërfaqësore në nivel të ulët si dhe nga ana njerzore duke tentuar të formojnë kullota apo zjare për arsyje pastrimi teritoret nga shkuret ferrat apo dalja nga kontrolli i zjarreve që mundë të ndezen për tu ngrohur apo gatuar nga kampingjet apo barinjtë, si dhe nga energjia elektrike duke qenë se rrjeti elektrik është i vjeter dhe telat janë rënë poshtë nga erërat bëjnë kontakt dhe janë bërë shhkak për zjarret në pyje, livadhe dhe kullota.

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

Risku teknologjik i referohet rrezikut nga një aksident madhor, një burimi rreziku që ka potencialin për të shkaktuar një incident madhor, i cili rezulton në shumë viktima dhe/ose në dëme të konsiderueshme ndaj një centrali, pajisjeje ose mjedisit. Një rrezik që e ka origjinën nga kushtet teknologjike ose industriale, duke përfshirë aksidentet, procedurat e rrezikshme, problemet në infrastrukturë ose aktivitete të caktuara njerëzore, të cilat mund të shkaktojnë humbje të jetës, lëndime, sëmundje ose ndikime të tjera në shëndet, dëmtime të pronës, humbje të mjeteve të jetesës dhe shërbimeve, çrregullime sociale dhe ekonomike ose dëme mjedisore.

Vendi përballet me një nivel të konsiderueshëm kërcënimi ndaj fatkeqësive por shpeshtësia dhe shkalla e kërcënimit nuk është e njëjtë në pjesë të ndryshme të territorit. Megjithatë, kur ndodh një fatkeqësi, ajo ka gjasa të rezultojë në: humbje në njerëz dhe gjënë e gjallë; dëmtim dhe shkatërrim të pronës; dëmtim të infrastrukturës; dhe dëmtim të mjedisit.Krahas rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore në territorin e Bashkisë Has, rritja e cenueshmërisë së komunitetit është një faktor që kontribuon ndjeshëm në riskun e përgjithshëm dhe mundësinë e fatkeqësive në vend. Tendencat në vijim në Shqipëri kontribuojnë në rritjen e cenueshmërisë.

- Rritja e popullsisë dhe rrjedhimisht rritja e dendësisë së strehimit, si dhe investimi në tokat bujqësore dhe jo urbane.
- Zhvendosja nga zonat rurale në ato urbane dhe presioni i urbanizimit, i cili çon në përqendrimin e njerëzve në zona urbane të pasigurta.
- Degradimi i burimeve natyrore (p.sh., mbikullotja e lëndinave dhe mbishfrytëzimi i pyjeve).
- Varfëria ende ekzistuese dhe rritja e numrit të njerëzve të varfër që janë të ekspozuar ndaj rreziqeve.
- Masa të pamjaftueshme në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë, si dhe teknika të pamjaftueshme të parashikimit dhe parandalimit.
- Mungesa e masave strikte për kontrollin mjedisor.
- Kapacitete të dobëta institucionale dhe burime të pakta për përballimin e fatkeqësive në masë.
- Arsimim dhe trajnim i pamjaftueshëm i personelit të mbrojtjes civile dhe popullsisë lidhur me masat e mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes.
- Pjesëmarrje e ulët e komuniteteve vendore në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë.

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile është dokumenti kryesor në fushën e emergjencave civile. PKEC i Shqipërisë shqyrton risqet e mundshme në vijim nga fatkeqësitë, të cilat duhet të merren në konsideratë për zhvillimin e kapaciteteve të brendshme të sistemit të MRF-së në vend.

- Përmbytjet;
- Tërmetet;
- Zjarret në pyje;
- Rrëshqitjet e tokës;
- Bllokimet nga reshjet e dendura të dëborës dhe ortekët;
- Epidemitë;
- Shpërthimet e digave.

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

Përvoja e Shqipërisë dhe e vendeve të tjera shfaq nevojën për zhvillimin e një qasjeje sistemike për menaxhimin e risqeve të mundshme ndaj fatkeqësive.

Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë është një investim ekonomik në parandalimin e humbjeve ekonomike në të ardhmen dhe menaxhimi efikas i risqeve nga fatkeqësitë kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm. Që nga miratimi i Kuadrit për Veprim të Hyogos (KVH), Shqipëria, së bashku me disa vende të tjera dhe me grupet përkatëse të interesit në mbarë botën, kanë bërë progres në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe global, çka ka çuar në rënien e vdekshmërisë në rastin e disa rreziqeve.

Kuadri pasues i KVH-së dhe konventa e re globale për ZRF-në, Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015-2030, ose KS për ZRF, synon të plotësojë këto mangësi përmes një kuadri të orientuar drejt veprimeve, i cili mund të zbatohet nga qeveritë në një mënyrë që mbështet MRF-në dhe plotëson objektivat e tjera për zhvillim, duke lehtësuar njëkohësisht identifikimin e risqeve nga fatkeqësitë, mënyrën e menaxhimit të tyre, si dhe duke drejtuar investimet që do të përmirësojnë aftësitë ripërtëritëse.

Në nivel global, SKZRF synon të arrijë rezultatin në vijim, deri në vitin 2030: ***"Zvogëlimi i ndjeshëm i riskut nga fatkeqësitë ndaj jetës, mjeteve të jetesës dhe shëndetit, si dhe ndaj aseteve ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore, të njerëzve, bizneseve, komuniteteve dhe vendeve".***

Për të patur rezultat, nevojitet përmirësimi i aftësive dhe kapacitetit zbatues të vendeve në zhvillim dhe me të ardhura mesatare për të përballuar sfidat dhe në veçanti, mobilizimi i komunitetit ndërkombëtar për të mbështetur zbatimin e planeve specifike të vendeve, në përputhje me prioritetet kombëtare të çdo vendi.

3- Qëllimi dhe objektivat

Vlersimi i riskut në nivel bashkie ka si qëllim kryesor: Organizimin në kohë të veprimtarive bashkërenduese të autoriteteve shtetërore, të strukturave të qeverisjes vendore, të subjekteve private dhe të OJQ-ve të cilat veprojnë në territorin e bashkisë, për përcaktimin e risqeve dhe të meren masa për investime me qëllim zvoglimin e tyre, të parandalohet zhvillimi i risqeve, të menagjohen risqet, për parandalimin e çdo situate emergjente të shkaktuar nga fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera të cilat kërcënojnë apo dëmtojnë jetën e njerëzve, pronën, gjënë e gjallë, trashëgiminë kulturore, mjedisin etj. Të përcaktojnë përgjegjësitë e aktorëve pjesëmarrës për parandalimin dhe përballimin e emergjencave si dhe detyrat e gjithsecilit. Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë mbështet në zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për menaxhimin dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, si dhe në forcimin e të gjithë sistemit të MRF-së në vend. Gjithashtu, ai synon të japë njohuri domethënëse rreth procesit të mëtejshëm për zvoglimin e riskut. Në nivel vendorë, gjetjet e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë do të lehtësojnë procesin e fuqizimit të kuadrit të politikave për MRF-në duke kontribuar në zhvillimin e Strategjisë Vendore për MRF-në dhe të Planit për Emergjencat Civile. Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë mbështet fuqizimin institucional të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civil.

Është e rëndësishme të nënvizohet se raportet e vlerësimit të riskut në nivel vendorë, të cilat janë përgatitur për secilin prej risqeve të identifikuara, janë një pjesë e domosdoshme e raportit të konsoliduar të vlerësimit të riskut. Ata janë hartuar në përputhje me ligjin Nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", Vendim Nr. 94, datë 22.2.2023 "Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare Për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030 dhe Planit të Veprimit",Vendim Nr. 168, Datë 24.3.2023 "Për Miratimin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror" Në këtë kuadër Bashkia Has ka ndërmarrë një sër iniciativa për mbrojtjen dhe zvoglimin e

risqeve. Janë hartuar Plane për mbrojtjen dhe zvoglimin e risqeve dhe në bashkëpunim me grupet e interesit janë hartuar hartat e risqeve si dhe rrëgjistri i riskut, janë ndërmarrë hapa konkret në terren që nga pyllëzimet në zonat me rrëshqitje, pritat malore, ngritjen e grupe vullnetare në çdo njësi administrative, janë shtuar burimet njerëzore dhe kapacitetet e mjeteve (mjetet për ndërhyrje në raste emergjencash janë të pakta, si dhe burimet njerzore duhet të trajnohen) .

Nga vlersimi i riskut për teritorin e Bashkisë Has synojmë :

- ✓ Të parandalohet, të lehtësohet dhe të riaftësohet nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile.
- ✓ Të garantohet përdorimi i të gjitha burimeve të mundshme të shtetit me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë , lokalizimin e zonës së riskut dhe lehtësimin e pasojave të mundëshme.
- ✓ Të sigurohen kushtet për institucionet shtetërore, publike dhe private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për humbje sa më të vogla, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin, ndaj efekteve të një emergjence civile.


4. Mbledhja e të dhënave për vlerësimin e riskut

4.1 Popullsia

Fig.2 Të Dhënat e Popullsise

Të dhëna administrative	Vlerë
Sipërfaqja	399.62 km^2
Popullsi bashkisë	11,684 (5,684 meshkuj/ 6,000 femra (Cens 2023) ndersa sipas Regjistrit të Gjendjes Civile në Nentor 2025 Bashkia Has ka nje Popullsi të regjistruar 22,987 banorë.
Njësi administrative	Krumë, Golaj, Fajza, Gjinaj
Fshatra të përfshira	29 fshatra

Fig. 3 *Të dhëna demografike*



Sipas të dhënave më të fundit demografike, numri total i banorëve në Bashkinë Has është 11,684 banorë, me një shpërndarje të përafërt gjinore prej 5,684 meshkuj dhe 6,000 femra, ndersa sipas Regjistrimit të Gjendjes Civile Bashkia Has në vitin 2025 ka një popullsi të regjistruar prej 22,987 banorë.

4.2 Banesat, Monumentet Kulturore, Shkollat.

Ndërtimi i banesave në Has.

a) Para viteve '90

- Banesat tradicionale në Has ndërtoheshin kryesisht me gurë të mëdhenj, dru dhe baltë.
- Shumë shtëpi ishin 1–2 kate, me çati të mbuluara me tjegulla ose llamarinë.
- Ndërtimet ishin të karakterit familjar dhe mbështeteshin në mjeshtërinë lokale.
- Fshatrat shpesh kishin shtëpi të shpërndara në distancë, për shkak të relievit kodrinor-malore.

b) Periudha pas viteve '90

- Filloi ndërtimi i banesave me blloqe betoni, tulla të pjekura dhe shpesh pa mbikëqyrje teknike profesionale.
- Migracioni masiv ndikoi në braktisjen e shumë shtëpive të vjetra.
- Në qendrat urbane (p.sh. qyteti i Krumës) u rrit numri i ndërtesave shumëkatëshe.
- Ndërtimet shpesh u bënë pa plane urbanistike të detajuara dhe pa studime gjeologjike mjaftueshëm të thelluara.

c) Vitet e fundit.

- Përdorim më i shpeshtë i materialeve moderne si beton i armuar, tulla termosuese, izolime.
- Rritje e ndërgjegjësimit për standardet antisizmike, sidomos pas tërmetit 2019 në Shqipëri.
- Projekte të reja të infrastrukturës dhe investime publike kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë së ndërtimit.

Ndërtesat në Fshatrat e Bashkisë Has pothuajse janë të gjitha me risk te lart pasi janë të vjetra, një pjesë janë të reja te cilat nuk përbëjn rrezik.

Në Krumë pothuajse shumica e ndërtesave janë të reja dhe rezistente ndaj fatkeqësive natyrore, përjashtu pallatet të cilat janë të ndërtuara në vitet 70-90 dhe mund te kategorizohen me risk mesatar ndaj fatkeqësive.

Monumentet Kulturore dhe trashegimia kulturore.

Në rrethin e Hasit kemi 1 Muze dhe 12 Kulla.

Muzeu Etnografik, Krumë Has i cili është djegur në vitin 2020, monument kulture i kategorisë II, ku ka rrezik te larte shembjeje ku kategorizohet me risk te lart, pasi ndodhet afer Shkolles se Mesme dhe Shkolles 9-Vjeçares.

Kulla e Arif Adem Çeles, Helshan Has si pasoje e amortizimit nder vite dhe kushteve natyrore është demtuar (shembur).

Kulla e Kurpalve, Letaj Has, e shpallur shtepi Muze, e restauruar dhe e hapur per vizitoret, Kategoria II

Kulla e Musli Ram Gjonit, Kosturr dhe Kulla e Zymer Asllan Dautit janë të banueshme, pavaresiht se janë të vjetra dhe të ekspozuara nga fatkeqësitë për shkak të viteve të ndërtimit.

8 Kulla të tjera në territorin e Bashkisë Has rrezikojnë shembjen dhe përben një risk te lart si në njerëz po ashtu dhe në ruajtjen e monumenteve dhe trashegimisë kulturore.

Shkollat.

Shkolla 9-Vjeçare në Qendër Krumë është e ndërtuar në 10 vjeçarin e fundit dhe në kushte të mira për procesin mesimor e cila nuk perben rrezik , po ashtu dhe shkolla 9-Vjeçare në Fshatin Letaj, Vranisht, Tregtan, Fajza, Helshan.

Shkolla e mesme Qendër Krumë është restauruar dhe dhe në kushte të mira për procesin mesimor e cila nuk perben rrezik.

Shkollat e tjera si pasoje e viteve të hershme të ndërtimit dhe amortizimeve nder vite nga faktor natyrore jane me rrezik te larte shembjeje ku kategorizohet me risk të lart për nxenesit, mesuaesit, sidomos Shkolla 9-Vjeçare Mujaj dhe Shkolla 9-Vjeçare Vlahen.

4.3 Infrastruktura kritike dhe publike

Infrastruktura kritike dhe publike mund të ndahet në dy kategori: Infrastrukturë pikësore dhe Infrastrukturë linjore. Të dhënat e mbledhura mbi infrastrukturën kritike dhe publike pikësore jepen në tabelën vijuese.

Fig. 4: Infrastruktura kritike dhe publike

Njësia administrative	Monumente Kulture	Diga	Ura	Sistemi shëndetësor	Sistemi arsimor
KRUMË	2	2	2	1 Spital, 1 Q.SH dhe 5 Ambulanca	1 Shk. Mesme 3 9-Vjeçare
GOLAJ	10	14	18	1 Q.SH dhe 12 Ambulanc	1 SH. M.B, 6 Sh. 9-Vjeçare, 2 Sh. Fillore
FAJZA	1	8	6	1 Q.SH dhe 6 Ambulanca	4 Sh. 9-Vjeçare
GJINAJ	0	0	0	5 Ambulanca	1 Sh. 9-Vjeçare

4.3.1Rrjeti rrugor.

Rrethi jonë përshkohet nga 66.3 km rrugë nacionale, dhe 39 segmente rrugore me 176.6 km.

	I. GOLAJ	Bashkia Has	Gjatesia (Km)	E asfaltuar (Km)	E pa asfaltuar (Km)
1		R.N.13 –Helshan B.Liqenit	7		Çakell
2		Helshan - Kosturr	4		Çakell
3		Qender Helshan -	2.8		Çakell
4		R.N.13 - Perollaj	4.2	Asfalt	
5		Letaj - Peraj	2		Çakell
6		Peraj - Zgjeç	4		Çakell
7		Plepa – Pla i Pates	5		Çakell
8		Golaj Qender – Unaze Dautaj	4.8	Asfalt	
9		R.N.13 Dobrune	7.9	Asfalt	
10		R.N.13 - Nikoliq	5		Çakell
11		Letaj – Dobrune	4.5		Çakell
12		R.N.13 - Vlahen	6	Asfalt	
13		Vlahen – Muhader	4		Çakell
14		Nikoliq - Vlahen	3.9		Çakell
15		Golaj – Fabrike e Pasurimit	3		Çakell
16		Bregu i Vlahnës-Ngjeç	2.5		Çakell
	II.QENDËR KRUME				
17		Krume - Cahan	11		Çakell
18		Cahan - Dajç	4		Çakell
19		Cahan - Kishaj	3.4		Çakell
20		RN13-Rad-Gec	2.9		Çakell
21		RN13 - Gajrep	3.5		Çakell
22		RN13 - Zahrisht	5	Asfalt	-
	III. FAJZA				
23		Sefoll – Fajza	4		Çakell
24		Fajza – Liqe I Kuq	9		Çakell
25		Tregtan - Brenoge	7		Çakell
26		Tobel – Metaliaj	3		Çakell
27		Tobel- Myç Has	6.5	Asfalt	-
28		Metaliaj – Bregu I Liqenit	4		Çakell
29		Metaliaj - Beg	2		Çakell
30		Vranisht - Fajza	4.5		Çakell
31		Vranisht Qender - Mazrek	3		Çakell
32		Vranisht –Bregu i Krumes	3.5		Çakell
33		Bregu i Krumes – Pla i Krumes	4		Çakell
34		Vranisht - Cenali	2		Çakell
	IV.GJINAJ				
35		RN13 - Gjinaj	4		Çakell
36		Gjinaj – Pus I Thate	3.5		Çakell
37		Gjinaj - Domaj	7		Çakell
38		Domaj- Pogaj	5		Çakell
39		Kishaj-Mariç-Pogaj	4.2		Çakell
		SHUMA TOTAL	**176.6 Km**		

Fig. *5: Inventari i Rrjetit Rrugor në Bashkinë Has.*

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

4.3.2Rrjetet e kullimit/ujitës.

Rrjeti i sistemit ujitës dhe kullues në Bashkinë Has përfshin rreth 314 km rrjet ujitës dhe 81 km rrjet kullues.

4.3.4Linjat elektrike.

Rrjeti elektrik në bashkinë Has përfshin 5.4 km linjë 110 KW dhe 7.7 km linjë 220KW. Duke qenë se rrjeti i linjave elektrike është i hershëm dhe si pasoje e mos investimit ne linjat, ka demtime ne rrjetin eketrik dhe ne shtyllat e linjave si pasoje e kushteve te motit (erërat , bora, ngrica). Si rezultat i ketyre problemeve ka nderpreje te energjise lektrike gjate dimerit dhe gjatë veres si rezultat i kontaktit te telave me njeri tjetrin nga erërat ku jan krijuar shkendi dhe jane bere faktor për renie zjarri ne livadhe, pyje, kullota.

Kjo mund të kategorizohet me risk mesatar dhe deri i lartë pasi, ndikon drejtërsëdrejti tek njerëzit, ekonomia, prona, pyjet, kullotat, etj.

4.4 Tokë bujqësore.

Në rrethin e Hasit siperfaqja totale e tokës bujqësore është 6545 ha. Përdorimi aktual i tokës (kullotë, arë, pemtore, të papunuara) janë: kullotë dhe livadhe 4642 ha, livadhe 345 ha, pemtore 246 ha, tokë arë ha.

Kategorizimi i tokës në rrethin e Hasit është e kategorisë V-VIII.

Zonat me rrezik të lartë për përmbytje, erozion apo degradim, janë: Shtrati i lumit Krumë, Shtrati i bregut të Vlahnës, shtrati i lumit Rusman.

5. Metodologjia.

Për vlerësime të ndryshme risku përdoren metodologji të ndryshme. Psh. Projekti me titull "Vlerësimi i rrezikut potencial dhe aktual i erozionit të tokës për të gjithë territorin e Shqipërisë nëpërmjet Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS) dhe ndërthurja e tij me teknologjinë e vlerësimit sipas CORINE LAND COVERALBANIA (CLC- 2010)" dhe kod 230 M8700057, 231 M8700058 është një realizim i bashkëpunimit te Departamenit të Gjeofizikës Rajonale dhe Inxhinierike dhe Departamentit të Sizmologjise së Institutit të Gjeoshkencave,Energjise,Ujit dhe Mjedisit.

Metodologjia që është zbatuar në të është e rekomanduar nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë të Kombeve te Bashkuara – Food and Agriculture Organization of the United Nations (FAO) - në kuadër të Programit të Koordinimit të Informacionit Mjedisor :
CORINE (Coordination Information Environment Programme) - i promovuar nga Komuniteti Evropian, DGXI. Ky program u prezantua zyrtarisht në Luksemburg në vitin 1992. Fillimisht objektivi i tij kryesor ishte mbledhja dhe përdorimi i të dhënave mjedisore për tu përdorur në studime me karakter tipik mjedisor si inventarizimi i biotopeve, ndotja atmosferike, ndotja e ujërave, erozioni i tokës apo cilësia e tokës në vendet e Komunitetit Evropian.
Njëkohësisht CORINE përfshinte edhe krijimin e një baze të dhënash në Sistemin e Informacionit Gjeografik – Geographic Information Systems (GIS) dhe shkëmbimin e të dhënave të krijuara. Erozioni është procesi gjatë së cilit dheu dhe shkëmbinjtë largohen nga sipërfaqja e tokës nga procese ekzogjene si era ose rrjedhjet ujore e me pas transportohen dhe depozitohen në hapësira të tjera.
Ndërkohë që erozioni është një proces natyror, aktiviteti njerëzor e ka rritur me 10 – 40 herë shkallën me të cilën erozioni po ndodh në shkalle globale. Bujqësia e bazuar në teknologjinë e pesticideve, shpyllëzimi, ndërtimi i rrugëve të reja, ndryshimet klimatike dhe zgjerimet urbane janë mes faktorëve më spikatës të këtij aktiviteti që stimulon erozionin.

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

Ky erozion i përshpejtuar shkakton njëherësh probleme që klasifikohen si 'on-site' dhe 'off-site'. Efektet "onsite" përfshijnë ulje në produktivitetin bujqësor dhe kolaps ekologjik pasi krijohet një humbje në nivelet e shtresave të sipërme që janë të pasura me elemente ushqyes për tokën.

Kjo metodologji përfshin tre faza kryesore:
1-Mbledhjen e të dhënave të nevojshme për riskun nga erozioni i tokës dhe cilësinë e tokës.
2- Integrimin e të dhënave në një sistem informacioni me baze hapësinore i cili mundëson analizimin e të dhënave në hapësirë dhe prezantimin e tyre në formë hartash.
3- Paraqitja e rezultateve të metodologjisë dhe vlerësimi i metodologjisë dhe rezultateve në terren për të përcaktuar nevojat për studim më të thelluar në të ardhmen.
Vlerësimi i riskut të erozionit bazohet në principet dhe parametrat e përcaktuara në Ekuacionin Universal të Ëischmeyer të Humbjes së Tokës - Ëischmeyer's Universal Soil Loss Equation (USLE) - sipas te cilit: (i) Erodibiliteti i tokës (faktori K) është në vetvete një funksion i parametrave të tokes si tekstura, përbërja organike, përshkrueshmëria dhe struktura (Ëischmeier, Johnson dhe Cross, 1971). (ii)
Eroziviteti nga reshjet (R). (iii) Faktori topografik: pjerrësia e shpateve në % (S) e shumëzuar me gjatësinë e shpatit në m (L). (iv) Mbulesa bimore (C), e cila % e gurëve Indeksi i erodibilitetit tekstura e tokës thellësia e profilit Indeksi i erozivitetit Indeksi Furnier Indeksi Bagnouls-Gaussen Indeksi i pjerrësisë së shpateve Harta e rrezikut potencial të erozionit Indeksi i përdorimit të tokës sipas CORINE

Harta e rrezikut aktual të erozionit "Vlerësimi i rrezikut potencial dhe aktual i erozionit të tokës pë të gjithë territorin e Shqipërisë nëpërmjet Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS) dhe ndërthurja e tij me teknologjinë e vlerësimit sipas CORINE Land Cover (CLC- 2010)" 3 merr në konsideratë densitetin e bimësisë dhe strukturën e saj.
(v) Praktikat menaxhuese të tokës (P).
Rezultatet integrohen në ekuacionin: E = K*R*S*L*C*P për të llogaritur erozionin e tokës (E).
Megjithatë, ky model nuk mund të përdoret në formën e tij origjinale, kjo për shumë arsye ndër të cilat: Fillimisht modeli është zhvilluar vetëm për kushtet e ndodhura brenda territorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe për tu përdorur jashtë tij duheshin bërë modifikime.
Modeli u zhvillua gjithashtu për përdorim në shkalle lokale, si ndihmë ndaj fermerëve prandaj përdorimi i tij në shkallë më globale kërkon modifikime. Për këto arsye projekti që është punuar bazohet në metodologjinë e modifikuar dhe të propozuar nga Komuniteti Evropian posaçërisht për territoret e Evropës Juglindore ku bën pjesë edhe Shqipëria. Për përgatitjen e tyre në këtë studim janë marrë parasysh të dy grupet e faktorëve që ndikojnë në këtë fenomen dhe këta janë: faktorët natyrorë: - tekstura e tokës - thellësia e tokës - prania e gurëve sasia e reshjeve, mesatare
mujore dhe mesatare vjetore - temperatura mesatare mujore dhe mesatare vjetore - pjerrësia e shpateve faktorët antropogjenë: - përdorimi i tokës (sipas nomenklaturës CORINE)

6. Konteksti i Vleresimit të Riskut.

Risku i fatkeqësisë nuk ka të bëjë vetëm me gjasat dhe ashpërsinë e ngjarjes së rrezikut, por edhe me atë që është e ekspozuar ndaj atij rreziku dhe sa i cënueshëm është ai ekspozim. Gjatë seminareve tona teknike në çdo bashki do të ndiqen hapat e mëposhtëm për të kryer Procesin e Vlerësimit të Riskut.

Vlerësimi i riskut është procesi i përgjithshëm i identifikimit të riskut, analizës së riskut dhe vlerësimit të riskut (ISO 31000).

Identifikimi i Riskut është procesi i gjetjes, njohjes dhe përshkrimit të risqeve. Identifikimi i riskut përfshin identifikimin e burimeve të riskut, ngjarjeve, shkaqeve të tyre dhe pasojave të mundshme të tyre. Identifikimi i riskut mund të përfshijë të dhëna historike, analiza teorike, opinione të informuara dhe të ekspertëve dhe nevojat e palëve të interesit.

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

Analiza e Riskut është procesi për të kuptuar natyrën e riskut dhe për të përcaktuar nivelin e tij. Analiza e riskut ofron bazën për vlerësimin e riskut dhe vendimet në lidhje me trajtimin e riskut. Analiza e riskut përfshin vlerësimin e riskut

Vlerësimi i riskut është procesi i krahasimit të rezultateve të analizës së riskut me kriteret e riskut për të përcaktuar nëse risku dhe/ose madhësia e tij është e pranueshme ose e tolerueshme. Vlerësimi i riskut ndihmon në vendimin për trajtimin e riskut.

Fig.6 :Konteksti i Vlerësimit të Riskut.




Fig.6

Identifikimi i riskut


Burimet e riskut duhet të identifikohen, të tilla si: fushat e ndikimeve, ngjarjet (duke përfshirë ndryshimet në rrethana) shkaqet e tyre dhe pasojat e tyre të mundshme. Qëllimi i këtij hapi është të gjenerojë një listë gjithëpërfshirëse të risqeve bazuar në ato ngjarje që mund të krijojnë, përmirësojnë, parandalojnë, degradojnë, përshpejtojnë ose vonojnë arritjen e objektivave.

Identifikimi i riskut duhet të përfshijë ekzaminimin e efekteve të dëmshme të pasojave të veçanta, duke përfshirë efektet zinxhir dhe të akumuluara. Duhet gjithashtu të marrë në konsideratë një gamë të gjerë pasojash edhe nëse burimi ose shkaku i riskut mund të mos jetë i dukshëm. Përveç identifikimit të asaj që mund të ndodhë, është e nevojshme të merren parasysh shkaqet dhe skenarët e mundshëm që tregojnë se çfarë pasojash mund të ndodhin. Duhet të merren parasysh të gjitha shkaqet dhe pasojat e rëndësishme.

Informacioni përkatës dhe i përditësuar është i rëndësishëm në identifikimin e riskut. Kjo duhet të përfshijë historikun e duhur të informacionit kur është e mundur. Njerëzit me njohuritë e duhura duhet të përfshihen në identifikimin e riskut.

Për secilin risk që do të studiohet, është e nevojshme të mblidhet informacioni i disponueshëmmbi përbërësit e riskut që lidhen me kontekstin e ~~MR~~ VR për të përgatitur:

- modelet e rrezikut;
- modelet e ekspozimit;
- modelet e cenueshmerisë;
- përzgjedhjen përkatëse të faktorëve kyç të riskut dhe kapaciteteve.



Identifikimi i Riskut

Fig. 7

Analiza e riskut

Analiza e riskut përfshin zhvillimin e një kuptimi të riskut. Analiza e riskut ofron një të dhënë për vlerësimin e riskut dhe për vendimet nëse risku duhet të trajtohet, dhe mbi strategjitë dhe metodat më të përshtatshme të trajtimit të riskut. Analiza e riskut mund të sigurojë gjithashtu një kontribut në marrjen e vendimeve kur duhet të bëhen zgjedhje dhe opsionet përfshijnë lloje dhe nivele të ndryshme të riskut.

Duke ndjekur përkufizimin e riskut të fatkeqësisë Sendai, dhe siç shpjegohet në seksionin "Kuptimi ynë i ToR" ne e konsiderojmë riskun të përbërë nga tre elementë.

- Rreziku: ngjarja e pafavorshme që shkakton humbjen.
- Ekspozimi: prona, njerëzit, bimët ose mjedisi që kërcënohen nga ngjarja.
- Cenueshmëria: si ekspozimi në risk është i cenueshëm ndaj një ngjarjeje negative të këtij lloji

Analiza e riskut përfshin shqyrtimin e shkaqeve dhe burimeve të riskut, pasojat e tyre pozitive dhe negative, dhe gjasat që ato pasoja mund të ndodhin.

Pasi të identifikohen risqet, probabiliteti që ato të materializohen dhe ashpërsia e ndikimeve të tyre të mundshme maten duke përdorur një grup kategorish që matin faktorët e riskut (matja në mënyrë ideale duhet të jetë sasiore). Kategoritë e ndikimit që duhet të merren parasysh janë njerëzore, ekonomike, mjedisore dhe politike/sociale (përfshirë sigurinë).

Për secilën kategori ndikimi, përcaktohet një nivel pasojash, p.sh., (1) i kufizuar / i papërfillshëm, (2) i ulët / i konsiderueshëm, (3) mesatar / i rëndë, (4) madhor / shumë i rëndë, (5) katastrofik / shkatërrimtar.

E njëjta ngjarje emergjente mund të sjellë më shumë se një pasojë. Nëse ngjarja prodhon më shumë se një pasojë përgjatë kritereve brenda së njëjtës kategori (p.sh., vdekje dhe lëndim në pasojat njerëzore), duhet të përdoret niveli më i lartë i pasojës. Nëse ngjarja prodhon më shumë se një pasojë në kategori të ndryshme (p.sh., pasoja në njerëz dhe ekonomike), secila pasojë duhet të shprehet veçmas.

Pas përcaktimit të nivelit të pasojës për secilin përshkrim risku, duhet vlerësuar niveli i gjasave që kjo pasojë të ndodhë.

Niveli i gjasave të ndodhjes pasqyron probabilitetin e të dyjave:

- ngjarjes emergjente dhe
- pasojave të vlerësuara që ndodhin si rezultat i ngjarjes (p.sh., vdekje, dëmtime).

Në këtë fazë, çdo risk duhet të ketë të caktuara nivelet e pasojave dhe gjasave të ndodhjes. Matrica cilësore e riskut kombinon nivelet e pasojave dhe të gjasave të ndodhjes për të përcaktuar nivelin e riskut, i cili varion nga shumë i ulët në ekstrem. Niveli i riskut për secilin risk duhet të regjistrohet.

Mënyra në të cilën shprehen pasojat dhe gjasat e ndodhjes dhe mënyra në të cilën ato kombinohen për të përcaktuar një nivel risku duhet të pasqyrojë llojin e riskut, informacionin në dispozicion dhe qëllimin për të cilin do të përdoret produkti i vlerësimit të riskut. Të gjitha këto duhet të jenë në përputhje me kriteret e riskut. Është gjithashtu e rëndësishme të merret parasysh ndërvarësia e risqeve të ndryshme dhe burimeve të tyre.

Besimi në përcaktimin e nivelit të riskut dhe ndjeshmëria e tij ndaj parakushteve dhe supozimeve duhet të konsiderohet në analizë dhe t'u komunikohet në mënyrë efektive vendimmarrësve dhe, sipas rastit, palëve të tjera të interesit. Faktorë të tillë si divergjenca e opinioneve midis ekspertëve, pasiguria, disponueshmëria, cilësia, sasia dhe rëndësia e vazhdueshme e informacionit, ose kufizimet në modelim duhet të deklarohen dhe mund të theksohen.

Analiza e riskut mund të ndërmerret me shkallë të ndryshme detajesh, në varësi të riskut, qëllimit të analizës dhe informacionit, të dhënave dhe burimeve të disponueshme. Analiza mund të jetë cilësore, gjysmë sasiore ose sasiore, ose një kombinim i tyre, në varësi të rrethanave.

Pasojat dhe gjasat e tyre mund të përcaktohen duke modeluar rezultatet e një ngjarjeje ose grupi ngjarjesh, ose me ekstrapolim nga studimet eksperimentale ose nga të dhënat e disponueshme. Pasojat mund të shprehen në terma të ndikimeve të prekshme dhe të paprekshme. Në disa raste, kërkohet më shumë se një vlerë numerike ose përshkrues për të specifikuar pasojat dhe gjasat e tyre për kohë, vende, grupe ose situata të ndryshme.

Vlerësimi i riskut

Qëllimi i vlerësimit të riskut është të ndihmojë në marrjen e vendimeve, bazuar në rezultatet e analizës së riskut, se cilat risqe kanë nevojë për trajtim dhe prioritetin për zbatimin e trajtimit.

Vlerësimi i riskut përfshin krahasimin e nivelit të riskut të gjetur gjatë procesit të analizës me kriteret e riskut të përcaktuara kur konteksti është marrë në konsideratë. Bazuar në këtë krahasim, mund të merret parasysh nevoja për trajtim. Vlerësimi i riskut kryhet bazuar në procedurën e mëposhtme:

Prioriteti i riskut

Rezultati i procesit të vlerësimit të riskut është caktimi i një prioriteti për secilin risk, bazuar në nivelin e riskut dhe besimin e lidhur me atë risk.

Pika e vendimit

Në këtë fazë, kërkohet një vendim nëse do të ndërmerren veprime të mëtejshme për secilin risk.

Renditja e riskut

Kur vlerësimi i riskut është i plotë (identifikimi, analiza dhe vlerësimi), në përgjithësi është e dëshirueshme që të renditen risqet në mënyrë që vlerësuesit e riskut të kuptojnë se cilat risqe duhet të merren parasysh së pari, së dyti, së treti etj. për planifikimin e trajtimit dhe/ose vlerësimin e mëtejshëm.

7. Kuadri ligjor dhe institucional për vlerësimin e riskut dhe mbrojtjen civile.

Gjatë tre viteve të fundit është përgatitur dhe miratuar një kornizë ligjore dhe institucionale përsa i përket vlerësimit të riskut të fatkeqësive dhe zvogëlimit/zbutjes së tij, si pjesë e paketës ligjore për mbrojtjen civile, përgatitur dhe miratuar nga institucionet qendrore. Përgatitja dhe miratimi i kësaj kornize ligjore dhe institucional është kryer në kuadër të proceseve integruese të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, duke zhvilluar një paketë të plotë gjithëpërfshirëse ligjore e nënligjore dhe duke ngritur dhe përforcuar gjithashtu institucionet dhe strukturat përkatëse.

Ligji bazë për paketën ligjore dhe institucionale është Ligji nr. 45/2019, datë 18.07.2019, "Për mbrojtjen civile", i cili ka vënë në zbatim pjesërisht edhe disa Direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian që kanë të bëjnë me mbrojtjen civile dhe vlerësimin e zvogëlimin e riskut të fatkeqësive sikurse janë:

- Direktiva e Këshillit 2008/ 114/KE, datë 8.12.2008, "Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre";
- Direktiva 2012/18/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 4.7.2012, "Mbi kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme, që ndryshon dhe më pas shfuqizon direktivën e Këshillit 96/82/KE. (Direktiva Seveso III);
- Direktiva 2002/22/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 7.3.2002, "Mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve në lidhje me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike" e ndryshuar, (Direktiva e shërbimit universal).

Kjo kornizë ligjore përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve (qendrore dhe vendore), subjekteve private, organizatave dhe shoqatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve në tërësi, së bashku me detyrimet përkatëse që lidhen me vlerësimin dhe zvogëlimi e riskut të fatkeqësive. Duke mbajtur parasysh që në aspektin ligjor dhe institucional veprimtaria në sektorin teknologjik/industrial ka veçoritë e veta, për vlerësimin e risqeve, në veçanti riskut teknologjik, krahas ligjit bazë dhe akteve nënligjore të nxjerra në mbështetje dhe për zbatim të tij, ka edhe një serë ligjesh dhe aktesh të tjera nënligjore, përkatësisht për sektorët ekonomikë, industrial dhe teknologjikë, si dhe për kryerjen e këtyre veprimtarive në territorin e bashkisë, të cilat janë marë parasysh në vlerësimin e riskut.

- Ligj nr. 75/2016, Datë 14.07.2016, Për ratifikimin e marrëveshjes së Parisit në kuadër të konventës së Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimaterike;
- Ligji nr. 115/2014 datë 31.7.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"
- Ligj nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, i ndryshuar

- Ligji nr. 7746, datë 28.7.1993 "Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe prodhimi)".
- Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre".
- Ligj nr. 116/2013 datë 15.04.2013, "Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)."
- Ligji Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 43/2015, datë 30.04.2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.
- V.K.M. nr. 477, datë 16.7.2004 "Për miratimin e Marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vëndburimin Patos Marinzë".
- VKM Nr. 1034, Datë 24-12-2020, Për miratimin e strategjisë kombëtare për sigurinë kibernetike dhe planin e veprimit 2020-2025;
- VKM nr. 747, Datë 20.11.2019, Për organizimin dhe funksionimin e AKMC;
- VKM nr. 147, Datë 18.03.2004, Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave;
- VKM nr. 431, Datë 15.07.2021, Për përbërjen dhe detyrat e njësive organizative që kanë në kompetencë të tyre çështjet e mbrojtjes civile në ministritë e linjës
- VKM nr. 1162, Datë 24.12.2020, Për Përcaktimin E Procedurave Dhe Të Afateve Për Pajisjen Me Vërtetim Për Riskun Të Subjekteve, Të Cilat Kërkojnë Të Pajisen Me Leje Zhvillimi/Ndërtimi
- VKM nr. 923, Datë 25.11.2020, Për Funksionimin E Organizimin E Komitetit Të Mbrojtjes Civile Dhe Bashkëpunimin Ndërinstitucional Të Institucioneve Dhe Të Strukturave Të Sistemit Të Mbrojtjes Civile".
- VKM nr. 1186, datë 24.12.2020, "Për miratimin e listës së objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike, pranë të cilave ngrihen stacionet e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit".
- VKM nr. 410, datë 13.5.2015, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial". Fletore Zyrtare nr. 137, datë 01.09.2015;
- VKM nr. 881, datë 14.12.2016. "Për miratimin e planit të përgjithshëm kombëtar të territorit", Fletore Zyrtare nr. 248, datë 23.12.2016;
- VKM Nr. 480, datë 31.7.2018, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030"; Fletore Zyrtare nr. 119, datë 9.08.2018;
- VKM nr. 87, datë 14.2.2018, "Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare", Fletore Zyrtare Nr. 23, datë 20.02.2018;
- VKM nr. 811, datë 16.11.2016, "Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe planit të veprimit 2016 – 2020"; Fletore zyrtare Nr. 220, datë 25 nëntor 2016;
- VKM nr. 553, datë 15.7.2020 Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit
- Udhëzim i Ministrit të Brendshëm nr. 81, datë 6.3.2020 – "Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe dhënia e certifikatës së sigurisë nga zjarri" .
- Urdhër i Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nr. 148, datë 20.4.1999, "Për Kushtet dhe Normat Teknike, që duhen respektuar në impiantet dhe instalimet e tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre".
- VKM nr. 168, datë 24.3.2023, "Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror", (Fletore Zyrtare nr.51/2023)
- VKM nr. 94, datë 22.2.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030 dhe planit të veprimit", (Fletore Zyrtare nr.31, 24.02.2023).

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

8. Përmbledhje e rreziqeve kryesore në Bashkinë Has.

Bazuar në objektivat e raportit të konsoliduar dhe duke përdorur metodologjinë e analizës së risqeve të shumëfishta, u realizua një shqyrtim dhe pikëzim krahasues për rreziqet kryesore dhe risqet kryesore nga fatkeqësitë të paraqitura në gjashtë raportet tematike. Për analizën u përdor sistemi i pikëzimit në vijim.

Rezultati	Niveli i riskut
0,00 – 1,00	Shumë i ulët
1.01 – 1,50	I ulët
1,51 - 2,00	I ulët në mesatar
2,01 – 2,50	Mesatar
2,51 – 3,00	Mesatar në të lartë
3,01 – 4,00	I lartë
4,01 – 4,50	Shumë i lartë
4,50 – 6,00	Ekstrem

Pikëzimi për nivelin e riskut bazohet në formulën në vijim për përllogaritjen e riskut.

R = P * I, Ku ***R*** është niveli i riskut,

P – Probabiliteti i ndodhjes së ngjarjes potenciale të fatkeqësisë si pasojë e rrezikut ekzistues,

I – ndikimi i mundshëm i ngjarjes potenciale të fatkeqësisë.

Ndikimi i mundshëm i fatkeqësisë merr në konsideratë faktorët në vijim:

I = Ex*V/CC,

Ku ***Ex*** është ekspozimi i infrastrukturës kritike dhe vendbanimeve njerëzore ndaj ngjarjeve të mundshme të fatkeqësive;

V – Cenueshmëria e infrastrukturës kritike dhe vendbanimeve njerëzore ndaj ngjarjes së fatkeqësisë

CC – kapacitetet përballuese të komuniteteve/qarqeve në rastin e një fatkeqësie.

Risku më i lartë nga fatkeqësitë në Bashkinë Has lidhet me rrëshqitjet e tokës, kërcënimet biologjike, të tilla si pandemia e COVID-19. Niveli relativisht i lartë shpjegohet nga probabiliteti i lartë i ndodhjes së këtyre ngjarjeve dhe nga ndikimi i mundshëm te njerëzit dhe

infrastruktura kritike. Tërmetet dhe zjarret masive të mundshme janë burime të fatkeqësive me risk mesatar, duke marrë në konsideratë nivelin e probabilitetit të ndodhjes dhe ndikimin e mundshëm. Çarja e digave dhe ortekët janë burime potenciale me nivel risku të ulët në mesatar.

Siç duket, risku nga fatkeqësitë për secilin lloj rreziku nuk është i shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë teritorin e bashkisë. Analiza në vijim paraqet shpërndarjen e risqeve nga fatkeqësitë sipas rreziqeve kryesore.

8.1 Rreziku i përmbytjeve.

Përmbytjet e shkaktuara nga lumenjtë e vegjël dhe përrenjte,shpesh prekin luginat e Rrethit te Hasit, duke dëmtuar rrjetin rrugor dhe tokat bujqësore. Janë një numër i vogël lumenjsh të vegjël ose përrenj që përfaqësojnë një rrezik të përhershëm për përmbytje. Karakteristika kryesore e tyre është se janë shumë të shpejtë dhe shpesh të "pa besë", sjellin volume të mëdha aluvionesh dhe mund të shkaktojnë dëme të pa parashikueshme në infrastrukturë, objekte banimi dhe bujqësi.

8.2 Rreziku nga zjarret.

Është klasifikuar si i lartë, çka do të thotë se ekziston një probabilitet më i lartë se 50% që vendi të përballet me një mot që mund të mbështesë një zjarr masiv, i cili ka gjasa të shkaktojë dëme të mëdha në pyje dhe kullota. Dëmet nga zjarret masive mund të ndodhin jo vetëm si pasojë e flakës së drejtpërdrejtë dhe ekspozimit nga rrezatimi por gjithashtu edhe si pasojë e stuhive që transportojnë materiale që digjen dhe e zjarreve sipërfaqësore në nivel të ulët si dhe nga ana njerzore duke tentuar të formojnë kullota apo zjare për arsyje pastrimi teritoret nga shkuret ferrat apo dalja nga kontrolli i zjarreve që mundë të ndezen për tu ngrohur apo gatuar nga kampingjet apo barinjtë.

8.3 Rreziku teknologjik.

I referohet rrezikut nga një aksident madhor, një burimi rreziku që ka potencialin për të shkaktuar një incident madhor, i cili rezulton në shumë viktima dhe/ose në dëme të konsiderueshme ndaj një centrali, pajisjeje ose mjedisit. Një rrezik që e ka origjinën nga kushtet teknologjike ose industriale, duke përfshirë aksidentet, procedurat e rrezikshme, problemet në infrastrukturë ose aktivitete të caktuara njerëzore, të cilat mund të shkaktojnë humbje të jetës, lëndime, sëmundje ose ndikime të tjera në shëndet, dëmtime të pronës, humbje të mjeteve të jetesës dhe shërbimeve, çrregullime sociale dhe ekonomike ose dëme mjedisore.

8.4 Rreziku nga aktivitetet sizmike.

Risku nga aktivitetet sizmike të cilat janë shndërruar lehtësisht në fatkeqësi si pasojë e mungesës së infrastrukturës së përshtatshme në territor, duke përfshirë ndërtesat dhe rrugët, përdorimit të papërshtatshëm të tokës, urbanizimit të shpejtë, veçanërisht në zonën përethë qytetit, si dhe si pasojë e kapaciteteve të kufizuara (në burime njerëzore dhe pajisje) në zvogëlimin e riskut nga tërmetet. Tërmeti i fundit, i datës 26 nëntor 2019, përshkruhet si një nga tërmetet më të forta që ka goditur Shqipërinë në 40 vite. Kjo fatkeqësi preku 11 bashki, 47 265 persona në mënyrë të drejtëpërdrejtë,155.028 persona dhe në mënyrë të tërthortë dhe shkaktoi humbjen e jetës së 51 personave dhe plagosjen e 913 të tjerëve. Vlera totale e përllogaritur e dëmeve dhe humbjeve ishte 985,1 milionë euro dhe përfaqëson 7,5% të produktit të brendshëm bruto të Shqipërisë në vitin 2019. Kjo nënkupton një barrë të rëndë mbi ekonominë e vendit, mjetet e jetesës dhe zhvillimin njerëzor. Rrethi i Hasit ashtu si vet pozicioni i vendit tonë shtrihet në brezin sizmik, alpin-mesdhetar,që përfshin zonën e kontaktit ndërmjet pllakave litosferike të Afrikës e të Euroazisë,e cila shtrihet nga ishujt Azore deri në kufirin lindor të pellgut të Mesdheut.

Rrethi i Hasit është shtrirë në zonat e ashtuquajtura "mesatare" për sa i përket intensitetit të termeteve. Shkalla e instensitetit është 6 deri në 7 ballë. Origjina e tërmeteve në Rrethin tonë është e karakterit tektonik. Faktorët që ndikojnë në intensitetin e tërmeteve është edhe fortësia e shkëmbinnjve.Kemi tre lloje shkëmbinjsh me forcë të lartë, mesatare e të ulët.

Rrethi i Hasit ka shkëmbinj me forcë relativisht të lartë dhe të ulët që përfaqësohen nga mbulesat e aluvioneve dhe deluvioneve. Intensiteti i tërmeteve me veprat inxhinierike që janë ndërtuar në shkëmbinj të fortë është më i vogel se në veprat inxhinierike që janë ndërtuar mbi veprat e aluvioneve dhe deluvioneve. Rrethi i Hasit është goditur nga tërmetet në viteve 1967, 1979, 1998 në fund të vitit 2004.

Rrethi i Hasit u godit gjatë vitit 2019 datë 21.09.2019 e 26.11.2019 ,ku kryesisht ka patur dëme në objekte ndërtimi.Sipas informacioneve të ardhura nga bashkitë ishin rreth **216 shtëpi banimi e 1 objekte social kulturor i dëmtuar.**

Në teritorin e Bashkisë Has nuk pati humbje jete por dëmet në objekte banimi dhe ifrstrukturë ishin të konsiderushme.

Disa prej rreziqeve të renditura mund të shkaktojnë fatkeqësi të lokalizuara në një territor dhe stinë të caktuar (për shembull, zjarret dhe zjarret në pyje, rrëshqitjet e tokës, rrokullisjet e shkëmbinjve, ortekët), ndërsa të tjera mund të shkaktojnë fatkeqësi me përhapje më të gjerë (p.sh., tërmetet, epidemitë etj.).

8.5 Rrëshqitja e tokës.

Vlerësimet e rreziqeve të mundshmë nga rrëshqitjet e tokës.

Rrethi i Hasit ka si tipar paqëndrueshmëritë masive të tokës, këto lloj fenomenesh gjeodinamike janë pasojë e kombinimit të faktorëve pasiv, ku futet ndërtimi gjeologjik dhe relievi, pjerrësia e madhe e shpateve si dhe e një rrjeti hidrografik të shumtë në të cilën lëvizin ujrat me shpejtësi të madhe.

Më të rrezikshme paraqitet në situatën kur këta shkëmbinj bien në drejtim të shpatit.
Një rol tejet negative ka luajtur vetë njeriu nëpërmjet shpyllëzimit e formimit të tokave të reja arë.
Sipas llojit të paqëndrueshmërisë së tokës kemi këto vecori në Rrethin e Hasit:

Rënia e shkëmbinjëve është karakteristikë e rajoneve malore të Alpeve të Shqipërisë, e shpateve gëlqerore të zbuluara ndaj kushteve të klimës së ftohtë dhe shirave të bollshme në masivin gëlqeror të malit të Pashtrikut.

Shembjet janë karakteristikë për rajonet malore të Rrethit. Raste të tilla janë përgjatë zones se Fshatit Kishaj, Cahan dhe në Fshatit Vlahën.

Rrëshqitjet me zhvendosje janë rrëshqitje më të dendura në Rrethin e Hasit.
Fshatrat më të rrezikshme janë Kishaj, Vlahën, Cahan.
Janë nje numer objektesh banimi të cilat me kalimin e viteve do të kenë probleme të drejtëpërsedrejti me këtë fenomen.

8.6 Rreziqet nga dëbora.

Është rrëziku periodik vjetor që përfshin Bashkinë Has.
Bashkia Has është i vendosur kryesisht në zonën e klimës mesdhetare paramalore dhe malore, nënzona veriore dhe lindore.
Në stinën e dimrit pjesa më e madhe e reshjeve bie në formë dëbore, që fillon nga muaji Tetor deri në fund të muajit Mars.

Trashësia mesatare e arrin nga 80 deri në 1 m, kurse në zonat malore mbi 1000 m mbi nivelin e detit arrin 1.5 deri në 2m.

Numëri mesatar i ditëve me dëborë është 40 deri në 100 ditë. Më shumë zgjat në muajin Janar 10 ditë.
Erërat veriore e verilindore janë karakteristike të periudhës dimërore të cilat përbëjnë 23.6% të të gjitha rasteve. Shpejtësia e erës mesatare shkon 11-15 $_{m/s.}$
Trashësia e mbulesës së dëborës prej 10 cm sjell një shtresë akulli me trashësi 5mm, që është e mjaftueshme për të ndërprerë trafikun normal dhe prek, madje pengon operacionet e emergjencës.
Megjithatë, grumbullimi i dëborës rreth 25-30 cm e bllokon tërësisht qarkullimin e makinave të zakonshme. Në rast se nuk bëhet pastrimi rregullisht prej dëborës, do të ketë problem dhe ndikon drejtpërsëdrejti tek njerëzit, levizja e automjeteve, ekonomia..

Bllokimi i popullsisë - rrëziku dhe elementët e parapërgatitjes.
Mundësia e bllokimit të popullsisë nga dëbora, e llogaritur si popullsi banuese brenda konturit të hapësirës që mbulohet me dëborë me lartësi të paktën 30 cm shkon deri në 51.3 % në kushtet e klimës më të skajshme e në ato të zakonshme varion 20-25 %. Duke mbajtur parasysh rezervat e ushqimit brenda shtëpive dhe furnizimeve të tjera, si dhe stoqet e tregut në vend, një periudhë bllokimi më e gjatë se 30 ditë duhet të quhet kritike për planifikimin e parapërgatitjes për emergjencat.
Më rrëzik më të madh nga dëbora dhe orteku kemi në njësinë Krumë, fshati Cahan, Mujaj, në Njësinë Administrative Gjinaj kemi fshatin Kishaj dhe në Njësinë Golaj fshatin Vlahën, Dobrunë, pasi nga reshje të mëdha dëbore gjatë dimrit, dhe duke qenë terren malor dhe i thyer, mundësia e orteqëve është e lartë si dhe mund të kemi dhe bllokime rrugësh.

8.7 Digat dhe rreziqet.

Ngritja e digave në Rrethin e Hasit ka nisur ps viteve 60'. Digat e para u ndërtuan për qëllime bujqësore. Sot ka 24 sisteme rezervuaresh me diga. Lartësia e të gjitha digave varion nga 16 m deri ne 36 m. Të gjitha digat e larta në Rrethin tonë janë të tipit me mbushje dheu. Kapaciteti ujëmledhës 10 milion m^3, kapaciteti ujitës 3430 Ha. Këto ujëmledhës kanë rrjedhje në saraqineska, ulje në nivelin e digës, kërkohet ndërhyrje ndërhyrje në shkarkuesin katastrofik.

Këto mund të futen te risku mesatar deri i lartë pasi çarja e digave ndikon drejtërsëdrejti në jetën e njerëzve, pronë, bujqësi, gjënë e gjallë, ekonomin etj.

Në **Njesinë Administrative Golaj** problematikë kemi këto rezervuare:

Kemi rezervuarin e **Helshan 1**, viti i ndërtimit 1970 me nje volum uji 000/ m3 580, ky rezervuar nga reshjet e mëdha të shiut rrezikon ndaljen e ujit mbi digë dhe poshtë tij ndodhet shkolla 9 vjeçare që rrezikohet si dhe nje pjesë e konsiderueshme e tokës bujqësore. Numri i nxënësve është 120, si dhe numri i banesave qe rrezikojnë është 60.

Për të eliminuar këtë emergjencë që mund të krijohet si rezultat i reshjeve të mëdha të shiut do të merren keto masa:

1. Pastrimi i shkarkuesit të rezervuarit në çdo kohë.
2. Shkarkimi i ujit në masën 30 %.
3. Në momente të caktuara nga vërshimet e medha te ujit, largimi i fëmijëve përkohësisht nga shkolla, si dhe lajmërimi dhe evakuimi i familjeve.

Kemi problematikë dhe disa të tjerë :

1. **Golaj 1.**

2. **Golaj 2.**

3. **Nikoliq 1.**

4. **Nikoli 2.**

5. **Qarr 2.**

6. **Dobrunë**.

Këto rezervuare, nga reshjet e mëdha të shiut rrezikojnë daljen e ujit mbi digë dhe rrezikojne një pjesë të mëdha tokë bujqësore si dhe disa familje. Për të eliminuar këtë emergjencë civile që mund të krijohet si rezultat i reshjeve të mëdha të shiut do të merren këto masa:

1. Pastrimi i shkarkuesit të rezervuarit në çdo kohë.

2. Riparimi i digës.

3. Shkarkimi i ujit në masën 30 %.

4. Në momente të caktuara nga vërshimet e medha te ujit, lajmërimi dhe evakuimi i disa familjeve.

Në **Njesinë Administrative Fajza** problematikë kemi këto rezervuare:

1. **Vranisht 1.**

2. **Vranisht 2.**

3. **Tregtan 1.**

Këto rezervuare, nga reshjet e mëdha të shiut, rrezikojnë daljen e ujit nga diga, si dhe rrezikojnë një pjesë të konsiderueshme të tokës bujqësore, si dhe disa familje. Për të eliminuar këtë emergjencë civile që mund të krijohet si rezultat i reshjeve të mëdha të shiut do të merren këto masa:

1. Pastrimi i shkarkuesit të rezervuarit në çdo kohë.

2. Riparimi i digës.

3. Shkarkimi i ujit në masën 30 %.

4. Në momente të caktuara nga vërshimet e medha te ujit, lajmërimi dhe evakuimi i disa familjeve.

4. Tobel

Viti i ndërtimit 1974 me një volum uji 000/m3 210, numri i banesave që rrezikohen është 50.

1.Ka ulje në kuroren e digës me 0.5 m.

2. Shkarkuesi nuk është në kushtet teknike nga amortizimi.

3. Skapata fundore e jashtme e digës ka pësuar shkarje të menjëhershme në një gjerësi rreth 15 m dhe gjatësi 25 m, thellësi 3 m.

5. Fajza

Viti i ndertimit 1975, me nje volum uji 000/ m3 850, kërkohet ndërhyrje në shkarkues mbasi nuk është veshur që kur është ndërtuar.

Në **Njësinë Krumë** problematikë kemi rezervuarin:

1. Rezervuarin Llakaj.

Viti i ndërtimit 1970, me një volum uji 000/ m3 2100, si dhe ka ulje në digë me 0.4 m. Duke qenë se rezervuari Llakaj është një ndër rezervuarët më të mëdhenjë në Bashkinë Has, numri i banesave qe rrezikohen rreth 130, dhe një pjesë e madhe e tokës bujqësore ndodhet poshtë rezervuarit, për të shmangur këtë emergjencë nga reshjet e mëdha të shiut duhet do të merren këto masa:

1. Pastrimi i shkarkuesit të rezervuarit në çdo kohë.

2. Shkarkimi i ujit në masën 30 %.

3. Në momente të caktuara nga vërshimet e mëdha të ujit, lajmërimi dhe evakuimi i disa familjeve.

2. Beres.

Viti i ndërtimit 1968, me nje volum uji 000/ m3 65, numri i banesave që rrezikojnë është 120.

1. Ujëleshuesi i bllokuar.

2. Ka ulje në kurorën e digës me 0.7 m

3. Shkarkuesi është i bllokuar jashtë funksionit.

Kushtet ekzistuese

Projektimi dhe ndërtimi i digave mbështetet në një analizë të gjithanshme të të gjithë faktorëve që lidhen me të dhe qe prekin sigurinë e vetë digës si dhe të sistemit digë/rezervuar. Për të siguruar kufijtë e sigurisë së projektuar gjatë gjithë periudhës së ekzistencës, rëndësi të dorës së parë ka mirambajtja e sistemeve gjatë shfruytëzimit të tyre. Mirëmbajtja e rregullt dhe e frytshme, duke përfshirë rehabilitimin në kohën e duhur, janë në vecanti thelbësore për sistemet digë/rezervuar ndërtuar me dhè e gurë. Me vjetrimin e digave, siguria e punës së tyre është problem. Kjo kërkon më shumë vëmendje në formën e inspektimeve, vlerësimeve, modifikimeve dhe përmirësimit të digave të vjetëruara, në mënyrë që të përballojnë standardet dhe rregullat e teknologjisë së kohës.

8.8 Rreziku Biologjik.

Rreziqet biologjike janë një burim kryesor risku që mund të rezultojë në emergjenca dhe fatkeqësi. Ato shkaktojnë humbje të konsiderueshme të jetës, prekin mijëra njerëz, mund të shkaktojnë humbje të mëdha ekonomike përmes humbjes së gjësë së gjallë dhe kulturave bujqësore, si dhe mund të shkaktojnë dëmtim dhe humbje të burimeve natyrore, duke përfshirë të faunës dhe florës së rrezikuar.Rreziqet biologjike kanë origjinë organike ose transmetohen përmes vektorëve biologjikë, duke përfshirë përmes mikroorganizmave patogjenë, toksinave dhe substancave bioaktive. Shembuj janë bakteret, viruset, parazitët, si dhe kafshët dhe insektet helmuese, bimët helmuese dhe mushkonjat që përçojnë agjentë që shkaktojnë sëmundje. Zakonisht, këto rreziqe janë rezultat i një ngjarjeje natyrore por mund të jenë gjithashtu rezultat i shkarkimeve të qëllimshme apo aksidentale. Rreziqet biologjike në vijim konsiderohen një burim i riskut të mundshëm biologjik në Shqipëri:

- Pandemia e vazhdueshme e COVID-19, e shkaktuar nga SARS-CoV-2,
- Rezistenca ndaj antibiotikëve,
- Fruthi,

- Sëmundjet me prejardhje nga uji të shkaktuara nga një shumëllojshmëri e patogjeneve të ndryshme.

Vendi përballet me një nivel të konsiderueshëm kërcënimi ndaj fatkeqësive por shpeshtësia dhe shkalla e kërcënimit nuk është e njëjtë në pjesë të ndryshme të territorit.

Megjithatë, kur ndodh një fatkeqësi, ajo ka gjasa të rezultojë në: humbje në njerëz dhe gjënë e gjallë; dëmtim dhe shkatërrim të pronës; dëmtim të infrastrukturës; dhe dëmtim të mjedisit.Krahas rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore në territorin e Bashkisë Has, rritja e cenueshmërisë së komunitetit është një faktor që kontribuon ndjeshëm në riskun e përgjithshëm dhe mundësinë e fatkeqësive në vend. Tendencat në vijim në Shqipëri kontribuojnë në rritjen e cenueshmërisë.

- Rritja e popullsisë dhe rrjedhimisht rritja e dendësisë së strehimit, si dhe investimi në tokat bujqësore dhe jo urbane;
- Zhvendosja nga zonat rurale në ato urbane dhe presioni i urbanizimit, i cili çon në përqendrimin e njerëzve në zona urbane të pasigurta;
- Degradimi i burimeve natyrore (p.sh., mbikullotja e lëndinave dhe mbishfrytëzimi i pyjeve);
- Varfëria ende ekzistuese dhe rritja e numrit të njerëzve të varfër që janë të ekspozuar ndaj rreziqeve;
- Masa të pamjaftueshme në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë, si dhe teknika të pamjaftueshme të parashikimit dhe parandalimit;
- Mungesa e masave strikte për kontrollin mjedisor;
- Kapacitete të dobëta institucion;
- Arsimim dhe trajnim i pamjaftueshëm i personelit të mbrojtjes civile dhe popullsisë lidhur me masat e mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes.
- Pjesëmarrje e ulët e komuniteteve vendore në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë;

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC) i vitit 2004, vazhdon të jetë dokumenti kryesor në fushën e emergjencave civile. PKEC i Shqipërisë shqyrton risqet e mundshme në vijim nga fatkeqësitë, të cilat duhet të merren në konsideratë për zhvillimin e kapaciteteve të brendshme të sistemit të MRF-së në vend.

- Përmbytjet;
- Tërmetet;
- Zjarret në pyje;
- Rrëshqitjet e tokës;
- Bllokimet nga reshjet e dendura të dëborës dhe ortekët;
- Epidemitë;
- Shpërthimet e digave

Përvoja e Shqipërisë dhe e vendeve të tjera shfaq nevojën për zhvillimin e një qasjeje sistemike për menaxhimin e risqeve të mundshme ndaj fatkeqësive.

Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë është një investim ekonomik në parandalimin e humbjeve ekonomike në të ardhmen dhe menaxhimi efikas i risqeve nga fatkeqësitë kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm. Që nga miratimi i Kuadrit për Veprim të Hyogos (KVH), Shqipëria, së bashku me disa vende të tjera dhe me grupet përkatëse të interesit në mbarë botën, kanë bërë progres në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe global, çka ka çuar në rënien e vdekshmërisë në rastin e disa rreziqeve.

Kuadri pasues i KVH-së dhe konventa e re globale për ZRF-në, Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015-2030, ose KS për ZRF, synon të plotësojë këto mangësi përmes një kuadri të orientuar drejt veprimeve, i cili mund të zbatohet nga qeveritë në një mënyrë që mbështet MRF-në dhe plotëson objektivat e tjera për zhvillim, duke lehtësuar njëkohësisht identifikimin e risqeve nga fatkeqësitë, mënyrën e menaxhimit të tyre, si dhe duke drejtuar investimet që do të përmirësojnë aftësitë ripërtëritëse.

Në nivel global, SKZRF synon të arrijë rezultatin në vijim, deri në vitin 2030: ***"Zvogëlimi i ndjeshëm i riskut nga fatkeqësitë ndaj jetës, mjeteve të jetesës dhe shëndetit, si dhe ndaj aseteve ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore, të njerëzve, bizneseve, komuniteteve dhe vendeve".***

Për të patur rezultat, nevojitet përmirësimi i aftësive dhe kapacitetit zbatues të vendeve në zhvillim dhe me të ardhura mesatare për të përballuar sfidat dhe në veçanti, mobilizimi i komunitetit ndërkombëtar për të mbështetur zbatimin e planeve specifike të vendeve, në përputhje me prioritetet kombëtare të çdo vendi.

9. NDARJA E SECILIT RISK ME TË DHËNA DEMOGRAFIKE DHE TERRITORIALE.

9.1. Risku nga tërmeti




Fig. 8

Rrethi i Hasit ashtu si vet pozicioni i vendit tonë shtrihet në brezin sizmik, alpin-mesdhetar,që përfshin zonën e kontaktit ndërmjet pllakave litosferike të Afrikës e të Euroazisë,e cila shtrihet nga ishujt Azore deri në kufirin lindor të pellgut të Mesdheut.

Rrethi i Hasit është shtrirë në zonat e ashtuquajtura "mesatare" për sa i përket intensitetit të termeteve. Shkalla e instensitetit është 6 deri në 7 ballë. Origjina e tërmeteve në Rrethin tonë

është e karakterit tektonik. Faktorët që ndikojnë në intensitetin e tërmeteve është edhe fortësia e shkëmbinnjve.Kemi tre lloje shkëmbinjsh me forcë të lartë mesatare e të ulët.

Rrethi i Hasit ka shkëmbinj me forcë relativisht të lartë dhe të ulët që përfaqësohen nga mbulesat e aluvioneve dhe deluvioneve. Intensiteti i tërmeteve me veprat inxhinierike që janë ndërtuar në shkëmbinj të fortë është më i vogel se në veprat inxhinierike që janë ndërtuar mbi veprat e aluvioneve dhe deluvioneve. Rrethi i Hasit është goditur nga tërmetet në viete 1967, 1979, 1998 në fund të vitit 2004.

Rrethi i Hasit u godit gjatë vitit 2019 datë 21.09.2019 e 26.11.2019, ku kryesisht ka patur dëme në objekte ndërtimi.Sipas informacioneve të ardhura nga bashkitë ishin rreth 216 shtëpi banimi e 1 objekte social kulturor i dëmtuar.

9.2. Risku nga rreshqitjet e tokës




Fig.9

Rrethi i Hasit ka si tipar paqëndrueshmëritë masive të tokës, këto lloj fenomenesh gjeodinamike janë pasojë e kombinimit të faktorëve pasiv, ku futet ndërtimi gjeologjik dhe relievi, pjerrësia e madhe e shpateve si dhe e një rrjeti hidrografik të shumtë në të cilën lëvizin ujrat me shpejtësi të madhe.

Më të rrezikshme paraqitet në situatën kur këta shkëmbinj bien në drejtim të shpatit.
Një rol tejet negative ka luajtur vetë njeriu nëpërmjet shpyllëzimit e formimit të tokave të reja arë.
Sipas llojit të paqëndrueshmërisë së tokës kemi këto vecori në Rrethin e Hasit:

Rënia e shkëmbinjëve është karakteristikë e rajoneve malore të Alpeve të Shqipërisë, e shpateve gëlqerore të zbuluara ndaj kushteve të klimës së ftohtë dhe shirave të bollshme në masivin gëlqeror të malit të Pashtrikut.

Shembjet janë karakteristikë për rajonet malore të Rrethit. Raste të tilla janë përgjatë zones se Fshatit Cahan dhe në Fshatit Vlahën.

Rrëshqitjet me zhvendosje janë rrëshqitje më të dendura në Rrethin e Hasit.
Fshatrat më të rrezikshme janë Kishaj, Vlahën, Cahan.
Rrëshqitje të tokës më të theksuara janë në Njësinë Administrative Fajza, në Fshatin Metaliaj dhe Vranisht.

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

Janë nje numer objektesh banimi të cilat me kalimin e viteve do të kenë probleme të drejtëpërsedrejti me këtë fenomen.

9.3. Risku nga zjarret.



Fig. 10

Rreziku nga zjarret është klasifikuar si i , çka do të thotë se ekziston një probabilitet më i lartë se 50% që vendi të përballet me një mot që mund të mbështesë një zjarr masiv, i cili ka gjasa të shkaktojë humbje të jetës dhe pronës në një vit të caktuar.

Po ti referohemi grafikut në zjarreve të rrëna në teritorin e bashkisë Has vihet re dendësia më e madhe është në zonat më të populluar kjo për arsye se në kët grafik janë zjarret e rëna në objekte banimi.

Sipërfaqja e madhe e kësaj pasurie, rëndësia e saj por edhe shpërndarja e madhe bën që ti kushtohet një rëndësi e madhë administrimit dhe mbrojtjes nga zjarri.Vitet e fundit zjarret janë shtuar edhe në objektet stallë dhe hangar.

Zjarret në pyje, në pesë vitet e fundit paraqesin një problem serioz për pyjet në Bashkinë HAS.

Për këtë flasin vëtë shifrat të cilat për periudhen **2017-2022** rezultojnë të janë pershkruar rreth **73** ha pyje , tokë pyjore apo kullota. Në vitet **2022-2025** rezultojnë të janë përshkruar **533.77** ha pyje, tokë pyjore dhe kullota. Renia e zjarrëve në pyje kullota janë rritur vitet e fundit të cilat po behen me risk të lart, duke ndikuar drejtpërsedrejti tek fermerët, bujqësia, blegtoria. Dëmet e këtyre zjarreve kapin vlera të konsiderueshme, kosto këto që përfshijnë dëmet direkte si edhe kostot për të riparuar pasojat e zjarreve. Përvec dëmit shumë të madh ekonomik, qe mund të shprehet në të holla, dëmi i shkaktuar në biocenozën e pyllit , pra dëmi ekologjik, është gjithashtu shumë i madh dhe nuk mund të shprehet dot në mënyrë financiare.

Arsyet e rënies së zjarreve janë nga më të ndryshmet , por në bazë të përvojave dhe njohurive të deritanishme në 99% të rasteve të shfaqjes së këtyre zjarreve si shkak paraqitet njeriu (direct ose indirect). Rrufeja apo vetëndezja e pyjeve kap vetëm 1% të rasteve. Renia e zjarreve në pyje/kullota ku shkaktar është njeriu ndodh nga pakujdesia , padituria , piromania si sëmundje apo qëllim i pastër. Zjarret e shkaktuara nga pakujdesia apo padituria , përfshijnë kryesisht zjarret e shkaktuara nga njerëzit që punojne në pyje apo kullota të cilët kryejnë punime operacionale në këto zona. Këto zjarre ndodhin zakonisht në pranverën e herëshme

kur vegjetacioni barror nga viti i kaluar është i thatë dhe vegjetacioni i ri akoma nuk ka filluar. Këtu si shkaktarë të zjarreve janë mbledhësit e frutave pyjore, bimëve medicinale, gjuetarët, fermerët apo edhe turistët.

Zjarret e qëllimshme bëhen me qëllim që të zgjerojnë tokën e punueshme apo kullotat, ku njeriu ndez zjarrin pa llogaritur pasojat. Motivet e këtyre zjarreve janë nga më të ndryshmet , ato mund të jenë edhe për përfitim ekonomik , për përfitim dru të lirë për dru zjarri apo ndërtim, për të mbuluar prerjet ilegale etj.



Fig. 11

9.4. Risku nga përmbytjet

Fig. 12

Rreziku i përmbytjeve.

Përmbytjet e shkaktuara nga lumenjtë e vegjël dhe përrenjte,shpesh prekin luginat e Rrethit te Hasit, duke dëmtuar rrjetin rrugor dhe tokat bujqësore. Janë një numër i vogël lumenjsh të vegjël ose përrenj që përfaqësojnë një rrezik të përhershëm për përmbytje. Karakteristika kryesore e tyre është se janë shumë të shpejtë dhe shpesh të "pa besë", sjellin volume të mëdha aluvionesh dhe mund të shkaktojnë dëme të pa parashikueshme në infrastrukturë, objekte banimi dhe bujqësi.

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

9.5 Risku nga orteku/bora




Fig. 13

Rreziqet nga dëbora

Është rrëziku periodik vjetor që përfshin Bashkinë Has.
Bashkia Has është i vendosur kryesisht në zonën e klimës mesdhetare paramalore dhe malore, nënzona veriore dhe lindore.

Në stinën e dimrit pjesa më e madhe e reshjeve bie në formë dëbore, që fillon nga muaji Tetor deri në fund të muajit Mars.
Trashësia mesatare e arrin nga 80 cm deri në 1 m, kurse në zonat malore mbi 1000 m mbi nivelin e detit arrin 1.5 deri në 2m.

Numëri mesatar i ditëve me dëborë është 40 deri në 100 ditë. Më shumë zgjat në muajin Janar, Shkurt.

Erërat veriore e verilindore janë karakteristike të periudhës dimërore të cilat përbëjnë 23.6% të të gjitha rasteve. Shpejtësia e erës mesatare shkon 11-15 m/s.

Trashësia e mbulesës së dëborës prej 10 cm sjell një shtresë akulli me trashësi 5mm, që është e mjaftueshme për të ndërprerë trafikun normal dhe prek, madje pengon operacionet e emergjencës.
Megjithatë, grumbullimi i dëborës rreth 25-30 cm e bllokon tërësisht qarkullimin e makinave të zakonshme. Në rast se nuk bëhet pastrimi rregullisht prej dëborës, kemi bllokimin e automjeteve, njerëzve.

Bllokimi i popullsisë - rrëziku dhe elementët e parapërgatitjes.

Mundësia e bllokimit të popullsisë nga dëbora, e llogaritur si popullsi banuese brenda konturit të hapësirës që mbulohet me dëborë me lartësi të paktën 30 cm shkon deri në 51.3 % në kushtet e klimës më të skajshme e në ato të zakonshme varion 20-25 %. Duke mbajtur parasysh rezervat e ushqimit brenda shtëpive dhe furnizimeve të tjera, si dhe stoqet e tregut në vend, një periudhë bllokimi më e gjatë se 30 ditë duhet të quhet kritike për planifikimin e parapërgatitjes për emergjencat.

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

Më rrëzik më të madh nga dëbora dhe orteku kemi në njësinë Krumë, Fshati Cahan, në Njësinë Administrative Gjinaj kemi fshatin Kishaj, Domaj, Gjinaj dhe në Njësinë Golaj fshatin Vlahën, pasi nga reshje të mëdha dëbore gjatë dimrit , dhe duke qenë terren malor dhe i thyer, mundësia e orteqëve është e lartë si dhe mund të kemi dhe bllokime rrugësh.

9.6. Risku Biologjik

Rreziqet biologjike janë një burim kryesor risku që mund të rezultojë në emergjenca dhe fatkeqësi. Ato shkaktojnë humbje të konsiderueshme të jetës, prekin mijëra njerëz, mund të shkaktojnë humbje të mëdha ekonomike përmes humbjes së gjësë së gjallë dhe kulturave bujqësore, si dhe mund të shkaktojnë dëmtim dhe humbje të burimeve natyrore, duke përfshirë të faunës dhe florës së rrezikuar.Rreziqet biologjike kanë origjinë organike ose transmetohen përmes vektorëve biologjikë, duke përfshirë përmes mikroorganizmave patogjenë, toksinave dhe substancave bioaktive. Shembuj janë bakteret, viruset, parazitët, si dhe kafshët dhe insektet helmuese, bimët helmuese dhe mushkonjat që përçojnë agjentë që shkaktojnë sëmundje. Zakonisht, këto rreziqe janë rezultat i një ngjarjeje natyrore por mund të jenë gjithashtu rezultat i shkarkimeve të qëllimshme apo aksidentale. Rreziqet biologjike në vijim konsiderohen një burim i riskut të mundshëm biologjik në Shqipëri:

- Pandemia e vazhdueshme e COVID-19, e shkaktuar nga SARS-CoV-2,
- Rezistenca ndaj antibiotikëve,
- Fruthi,
- Sëmundjet me prejardhje nga uji të shkaktuara nga një shumëllojshmëri e patogjeneve të ndryshme.

9.7. Risku nga Çarja e Digave

Në teritorin eBashkisë Has, risku nga çarja e digave ka nivel relativisht të ulët. Megjithatë, në disa Njësi Administrative si Golaj , Fajza, Krumë, mundësia e çarjes/prishjes dhe shkatërrimit të digave mund të shkaktojë një përmbytje me efekte zinxhir, e cila mund të ketë ndikim te komunitetet kryesishtë në dëme buqësore, në disa familje, si dhe një shkollë.

9.8. Risku Teknologjik

Risku nga fatkeqësitë teknologjike është rezultat i ndikimit antropogjenik të zhvillimit të shoqërisë. Fatkeqësitë teknologjike (ose teknogjenike) mund të shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore dhe anasjelltas. Shpeshherë, ato janë pjesë e një risku kompleks dhe me efekte zinxhir nga një fatkeqësi, në një rajon ose vend të caktuar. Duke marrë parasysh ndikimin e madh negativ që shkaktojnë në shoqëri, ekonomi dhe mjedis, fatkeqësitë teknologjike janë ato që duhet të merren në konsideratë me kujdes në proceset e menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë. Rreziqet kryesore teknologjike lidhen me sektorët ekonomikë në vijim:

- Prodhimi, transporti, magazinimi dhe tregtia e naftës dhe nënprodukteve të saj;
- Sektori i gazit natyror, duke përfshirë tubacionet e gazit;
- Sektori i energjetikës/energjisë, duke përfshirë prodhimin e energjisë elektrike dhe transportimin e saj;
- Materialet e rrezikshme të veprimtarisë së mëparshme industriale dhe stoqeve të municioneve ushtarake;

- Sektori minerar;
- Risku i lidhur me sektorin e transportit, duke përfshirë transportin rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror nuk u morën parasysh gjatë procesit të vlerësimit specifik të rrezikut.

10. Analiza e risqeve të shumëfishta për rreziqet kryesore në Njësitë Administrative të Bashkisë Has.

Qëllimi i analizës së risqeve të shumëfishta për rreziqet kryesore në qarqet e Shqipërisë është të krijojë njohuri më të mira rreth situatës së riskut nga fatkeqësitë në qarqe, të informojë strategjitë potenciale për zvogëlimin dhe menaxhimin e riskut, si dhe të ndihmojë vendimmarrësit në procesin e zhvillimit të programeve dhe projekteve të bazuara në informacionet mbi riskun Njësit Administrative janë të ekspozuara ndaj risqeve të shumëfishta nga fatkeqësitë.

Ekspozimi dhe cenueshmëria e njësive ndaj risqeve të ndryshme nga fatkeqësitë, varet nga disa faktorë, duke përfshirë, ndër të tjera, nga struktura gjeologjike, niveli i urbanizimit . Niveli i riskut nga fatkeqësitë në njësi klasifikohet bazuar në kombinimin e këtyre faktorëve dhe në mundësinë e ndodhjes së fatkeqësive komplekse dhe me efekte zinxhir. Skenari i riskut potencial nga fatkeqësitë sipas rreziqeve të shumëfishta: Rrëshqitje toke,zjaret dhe fatkeqësi të tjera.

10.1 Risku nga fatkeqësitë, Njesia Administrative Krumë.




Fig. 14

Në Njesinë Krumë risqet nga tërmetet dhe rreziqet teknologjike përfaqësojnë riskun më të lartë nga fatkeqësitë . Zjarret, përmbytjet, bora, çarja e digave kanë një risk të ulët deri mesatar, në këtë njësi, skenari i riskut kompleks dhe me efekte zinxhir përfshin fatkeqësitë madhore natyrore (tërmetet ose teknologjike), të cilat shkaktojnë aksidente të rënda teknologjike.

Probabiliteti i këtij skenari është mesatar, ndërsa ndikimi i mundshëm negativ është shumë i lartë.

10.2. Risku nga fatkeqësitë, Njesia Administrative Golaj.




Fig. 15

Në Njësin Administrative Golaj, risku i përmbytjeve nga çarjet e digave dhe zjarri, risqet teknologjike janë në nivelin mesatar.

Skenari i riskut kompleks dhe me efekte zinxhir përfshin fatkeqësitë madhore natyror (tërmetet ,borë, qarje digash), të cilat shkaktojnë aksidente, dëme në objekte banimi dhe infrastrukturë deri në bllokim të plotë.

Probabiliteti i këtij skenari është nga i ulët deri mesatar ndërsa ndikimi i mundshëm negativ është mesatarë.

10.3 Risku nga fatkeqësitë, Njesia Administrative Gjinaj.




Fig. 16

Njësia Administrative Gjinaj është një tjetër njësi e klasifikuar si me risk të ulët deri mesatar nga fatkeqësitë, risqet kryesore rrëshqitjet e tokës, , zjarret janë në nivel të lartë dhe fenomene të tjera atmosferike, në përgjithsi në këtë njësi risqet nga fatkeqësit janë mesatare, kryesishtë ato lidhen me zjarret masive dhe tërmetet e mundshëm, të cilët mund të shkaktojnë probleme të

mëdha në infrastrukturë prona dhe gjënë e gjallë. Probabiliteti i këtij skenari është mesatar dhe ndikimi i mundshëm është përllogaritur me nivel të ulët deri në mesatar.

10.4 Risku nga fatkeqësitë, Njesia Administrative Fajza.




Fig. 17

Njësia Administrative Fajza është një tjetër njësi e klasifikuar si me risk të ulët deri mesatar nga fatkeqësitë, risqet kryesore me zjarret, rrëshqitje të tokës, tërmetet e mundshëm, të cilët mund të shkaktojnë probleme të mëdha në infrastrukturë prona dhe gjënë e gjallë. Probabiliteti i këtij skenari është mesatar dhe ndikimi i mundshëm është përllogaritur me nivel të ulët deri në mesatar.

11. Qëllimi i raportit të konsoliduar për riskun nga fatkeqësitë në Shqipëri.

Qeveria shqiptare ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm gjatë viteve të fundit për të integruar ZRF-në në politikat dhe programet e zhvillimit, me qëllim mbrojtjen e zhvillimit të vendit. Krahas nënshkrimit të Kuadrit Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, Shqipëria është gjithashtu anëtare e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) dhe ka hartuar komunikime kombëtare në kuadër të KKKBNK-së.

Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë mbështet qeverinë shqiptare në zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për menaxhimin dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, si dhe në forcimin e të gjithë sistemit të MRF-së në vend. Gjithashtu, ai synon të japë njohuri domethënëse rreth procesit të mëtejshëm të rritjes së bashkëpunimit ndërmjet grupeve,

ndërkombtare të interesit të sistemit të MRF-së në vend, si dhe trajtojnë sfidat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimetarike Në nivel qendror, gjetjet e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë do të lehtësojnë procesin e fuqizimit të kuadrit të politikave për MRF-në duke kontribuar në zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për MRF-në dhe të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

11.1. Qasja e vlerësimit të rreziqeve të shumëfishta dhe risqeve të shumëfishta

Një qasje e risqeve të shumëfishta përfshin një perspektivë të rreziqeve të shumëfishta dhe cenueshmërive të shumëfishta. Ngjarjet komplekse dhe me efekte zinxhir dallohen nga niveli i tyre i kompleksitetit, jolinearitet dhe shpeshherë, nga ndërveprimi i tyre me infrastrukturën kritike, çka paraqet një sfidë komplekse për aftësitë ripërtëritëse. Kjo reflekton një evoluim nga analogjia e zbatuar më parë e "efektit domino", i cili nënkupton një shkaktar të njohur dhe një zinxhir të gjurmueshëm të ngjarjeve sekuenciale që çojnë në një përfundim të identifikueshëm. Perspektiva e rreziqeve të shumëfishta e trajton këtë sfidë duke u fokusuar në supozimet kryesore në vijim.

1. Burimet e ndryshme të rrezikut mund të përhapen në ***hapësira territoriale*** (p.sh., në zona administrative), të cilat ndodhen brenda referencës hapësinore të menaxhimit të riskut;

2. ***Risku kompleks*** - dy ngjarje të rrezikshme mund të ndodhin në të njëjtën kohë, pa pasur asnjë marrëdhënie shkak-pasojë;

3. ***Risku me efekte zinxhir*** - një ngjarje e rrezikshme mund të shkaktojë një tjetër ngjarje të rrezikshme, si rezultat i një efekti domino. *Rrezik me efekte zinxhir* mund të jetë, për shembull, një ngjarje sizmike që shkakton rrëshqitje toke ose një shpërthim industrial që shkakton një zjarr.

Gjashtë raportet tematike të përgatitura nga gjashtë ekipe të ndryshme ekspertësh përdorën metoda dhe sisteme vlerësimi të ndryshme. Ky fakt përbënte sfidën më të madhe në përgatitjen e raportit të konsoliduar. Metodologjia e risqeve të shumëfishta mundësoi trajtimin e çështjeve të lidhura me analizimin e një volumi të madh informacioni dhe vijoi me sintezën e risqeve komplekse (risqeve të shumëfishta) për secilin qark, siç përshkruhet më sipër. Vlerësimi i situatës së rreziqeve të shumëfishta dhe risqeve të shumëfishta është konsideruar një karakteristikë e territorit. Një qasje e risqeve të shumëfishta nuk duhet të shihet si një mënyrë për të zëvendësuar qasjet me një rrezik por si një mënyrë për të përmirësuar njohuritë mbi kompleksitetin e risqeve në një territor.

Për të prezantuar situatën me risqe të shumëfishta, është sugjeruar një sistem vlerësimi dhe pikëzimi për analizën krahasuese të vlerësimeve cilësore të paraqitura në gjashtë raportet tematike. Për të vlerësuar nivelet e riskut nga fatkeqësitë është aplikuar një shkallë nga **1** në **6**. Bazuar në informacionin nga gjashtë raportet dhe në pikëzimin krahasues të aplikuar të risqeve, janë përllogaritur pikët totale dhe/ose pikët mesatare për çdo risk nga fatkeqësitë, për secilin qark. Në këtë mënyrë u bë i mundur realizimi i disa analizave krahasuese dhe paraqitja e tablove vizuale të riskut nga fatkeqësitë në çdo qark. Tabela përkatëse që përmbledh pikët për tetë risqet nga fatkeqësitë, në të dymbëdhjetë qarqet e vendit, është paraqitur në shtojcën1

11.2 Kufizimet e metodologjisë

Një qasje e risqeve të shumëfishta synon të krijojë njohuri më të mirë mbi shumëllojshmërinë e risqeve në një territor. Megjithatë, kjo ngre disa çështje konceptuale, metodologjike dhe operacionale: analiza e risqeve të shumëfishta nuk mund të merret nga një agregim i thjeshtë i risqeve individuale. Një vlerësim objektiv i risqeve të shumëfishta ngre vështirësi si pasojë e problemeve në krahasimin e rreziqeve, cenueshmërive dhe risqeve. Një nga mënyrat për të trajtuar këtë problem metodologjik është integrimi i qasjes në të gjithë procesin e vendimmarrjes, me qëllim që të merret në konsideratë perceptimi i grupeve të interesit në përcaktimin e situatave me shumë risqe në qarqet e synuara. Rrjedhimisht, përdorimi i perspektivave të risqeve të shumëfishta ngre një sërë problemesh.

Vështirësia e parë lidhet me krahasimin e ngjarjeve të rrezikshme me njëra-tjetrën, pasi ato kanë ndryshime për sa i përket natyrës, intensitetit, periudhave të kthimit dhe efekteve që mund të kenë në elementët e ekspozuar. Nga pikëpamja e parandalimit të fatkeqësive, mund të jetë e vështirë të trajtohen ngjarjet që kanë nivele të ndryshme probabiliteti. Një ngjarje e vetme e rrezikshme, si p.sh. një tërmet me probabilitet të ulët/shkallë të lartë mund të shkaktojë po aq humbje sa përmbytjet e vazhdueshme me probabilitet të lartë/shkallë të ulët. Për më tepër, shkallët e tyre maten në mënyra të ndryshme, duke përdorur njësi të ndryshme referencë, si p.sh. shkarkimi ose thellësia e ujit për përmbytjet apo dridhja e tokës ose intensiteti makro-sizmik për tërmetet.

Vështirësia e dytë lidhet me krahasimin e cenueshmërive të elementëve të ekspozuar. Duke qenë se elementët e ekspozuar janë të ndryshëm (p.sh., popullsia kundrejt ndërtesave), parametrat për matjen e cenueshmërisë ndaj një burimi rreziku mund të jenë të ndryshëm (p.sh., numri i mundshëm i vdekjeve kundrejt nivelit të mundshëm të shkatërrimit) dhe nuk mund të shprehen gjithmonë duke përdorur një tregues përmbledhës. Për më tepër, nëse marrim në konsideratë burimet e ndryshme të rreziqeve, parametri i përdorur për të shprehur cenueshmërinë e një elementi të ekspozuar mund të jetë i ndryshëm: për shembull, në rastin e një përmbytjeje, cenueshmëria e një ndërtese mund të shprehet si shkalla e mundshme e dëmeve, ndërsa në rastin e shkarkimeve të lëndëve toksike, cenueshmëria mund të shprehet si koha e nevojshme për pastrimin e tyre.

Vështirësia e fundit lidhet me faktin se një qasje e risqeve të shumëfishta synon t'u paraqesë vendimmarrësve një panoramë përmbledhëse të risqeve në një territor. Kjo ngre problemin e vlerësimit të peshës së disa rreziqeve ose elementëve të ekspozuar në një territor. Vendimmarrësit dhe grupet e interesit mund të kenë perceptime të ndryshme mbi rëndësinë e çdo risku individual1. Për rrjedhojë, në vlerësimin e risqeve të shumëfishta duhet të merret në konsideratë perceptimi për risqet nga fatkeqësitë dhe rëndësia e çdo rreziku. Këto perceptime mund të jenë kontradiktore dhe procesi i vlerësimit të risqeve të shumëfishta duhet të bazohet në parimin e një qasjeje me pjesëmarrje. Duke qenë se një qasje e risqeve të shumëfishta synon të mbështesë procesin e menaxhimit të riskut, kërkesat e procesit të marrjes së vendimit duhet të udhëheqin qasjen e risqeve të shumëfishta. Për shkak të faktorëve logjistike dhe të kohës, nuk ishte e mundur të kryhej vlerësimi i duhur i perceptimeve të palëve kryesore të interesit dhe prezantimi i koeficienteve të peshimit për analizën krahasuese.

Nga pikëpamja konceptuale, koncepti i risqeve të shumëfishta lejon trajtimin e çështjeve të menaxhimit të risqeve nga një pikëpamje territoriale. Për rrjedhojë, kjo kërkon shqyrtimin e përkufizimeve ekzistuese të riskut, rrezikut, ekspozimit dhe cenueshmërisë në kuadër të një perspektive të risqeve të shumëfishta.

Nga pikëpamja metodologjike, qasja e risqeve të shumëfishta kërkon një qasje shumëdimensionale dhe koherente, të ndryshueshme në kohë dhe hapësirë. Problemet lidhen kryesisht me zgjedhjen e treguesve të saktë të riskut, si një funksion i disponueshmërisë së të dhënave, shkallës së analizës, instrumenteve dhe qasjeve të zbatuara për përmbushjen e objektivave të vlerësimit të risqeve të shumëfishta.

Nga pikëpamja operacionale, shtjellimi i analizës së risqeve të shumëfishta duhet të kontribuojë në integrimin e perceptimit të grupeve të interesit dhe të mbështesë qeverisje më të mirë brenda Ekspertët kryen vlerësime specifike të riskut të rrezikut dhe nxorën në pah mungesën e të dhënave lokale dhe analizave për të bërë vlerësimet e duhura të riskut zinxhir në nivelin lokal, kështu që përdoren disa përafrime gjatë analizës krahasuese të risqeve të shumëfishta.

12. Grupet kryesore të interesit.

Roli i grupeve kryesore të interesit, perceptimi i tyre mbi risqet nga fatkeqësitë madhore dhe angazhimi i tyre aktiv, janë thelbësore për një sistem efikas të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë. Grupet e interesit në vijim janë thelbësorë për funksionimin e suksesshëm të sistemit të MRF-së në Shqipëri.

1. **Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)** – aktori kryesor në kuadrin aktual të sistemit të MRF-së në vend. Ajo është agjencia udhëheqëse që ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për të garantuar zhvillimin e kapaciteteve të MRF-së në vend dhe angazhimin e grupeve të tjera kryesore të interesit në fusha të caktuara funksionale. Agjencia është përgjegjëse për koordinimin e punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, Planit Kombëtar për Emergjencat Civile dhe vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror. Agjencia organizon punën për ngritjen e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes civile në nivel qendror dhe vendor, si dhe për trajnimin e subjekteve private dhe vullnetare. Në nivel vendor, sipas ligjit "Për mbrojtjen civile", agjencia është e organizuar dhe operon në nivel rajonal përmes qendrave të mbrojtjes civile në të dymbëdhjetë qarqet dhe komisioneve të mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkie.

2. **Ministria e Mbrojtjes (MM)** – një nga grupet kryesore të interesit dhe një vendimmarrës në zhvillimin e sistemit të MRF-së. Aktualisht, AKMC është pjesë e strukturës së MM. Si e tillë, MM luan një rol të rëndësishëm në marrjen e vendimeve mbi strategjinë dhe funksionet e AKMC-së. Ligji "Për mbrojtjen civile" parashikon se Forcat e
   Armatosura angazhohen në operacione të ciklit të menaxhimit të fatkeqësive, nëse kapacitetet e tjera në dispozicion janë të pamjaftueshme për këtë qëllim, duke mbështetur institucionet, autoritetet qendrore e vendore dhe komunitetin. Struktura në varësi të ministrisë është Qendra Kombëtare e Shërbimit të Kërkim-Shpëtimit

3. **Prefektura** – së bashku me bashkitë, prefekturat janë partnerët kryesorë potencialë për zhvillimin e sistemit të decentralizuar të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë në vend. Ato janë të përfshira në të gjitha fushat funksionale të menaxhimit të riskut por roli i tyre është veçanërisht i rëndësishëm për identifikimin dhe gatishmërinë ndaj riskut nga fatkeqësitë. Ligji 45/2019 adresoi mangësitë në funksionimin e autoriteteve në nivel qarku dhe vendore gjatë emergjencave të kaluara, duke e vënë më tepër theksin te roli i prefektëve dhe kryetarëve të bashkive në koordinimin e strukturave për përgjigjen ndaj emergjencave në nivel qarku dhe vendor.
4. **Bashkia** – një nga grupet kryesore të interesit në sistemin e MRF-së në vend. Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", *"Bashkitë janë përgjegjëse për mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj"*. Përvoja e sistemeve të suksesshme të MRF-së tregon se bashkitë janë duke luajtur një rol thelbësor në garantimin e aftësive ripërtëritëse në nivel vendor dhe gatishmërisë ndaj goditjeve të mundshme. Ato janë padyshim të përfshira në të gjitha fushat kryesore funksionale të MRF-së. Bashkitë kanë përgjegjësinë e përgatitjes së vlerësimeve të riskut nga fatkeqësitë në nivel vendor. Për më tepër, ato duhet të përgatisin dhe miratojnë strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në bashki. Planet e zhvillimit urban në bashki duhet të harmonizohen me këto vlerësime dhe

strategji të riskut nga fatkeqësitë. Për më tepër, ligji 45/2019 kërkon që bashkitë të përgatisin planet vendore për emergjencat civile.

5. **Ministria e Brendshme (MB)** – një aktor i rëndësishëm në sistemin e MRF-së në vend. MB është aktori kryesor në fushat e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë, gatishmërisë dhe përgjigjes. Krahas sigurisë publike, Ministria e Brendshme është përgjegjëse për a) koordinimin me njësitë e vetë qeverisjes vendore dhe shoqatat e lidhura me to; b) hartimin e politikave, koordinimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri; c) mbrojtjen dhe kontrollin e territorit dhe ndërtimeve. MB kontribuon në menaxhimin e emergjencave përmes strukturave në varësi të saj, si Policia e Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Vendore dhe Prefekturat dhe Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

6. **Policia e Shtetit** – Strukturë aktive dhe operacionale gjatë një emergjence. Bazuar në nivelin e emergjencës, Policia e Shtetit mund të aktivizohet nga drejtuesi i operacioneve ndërkohë që forcat e tyre komandohen nga eprorët e përkatës.

7. **Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (ShMZSh)** – ka rol thelbësor për gatishmërinë dhe përgjigjen. Detyrat e ShMZSh janë standardizimi, kontrolli i zbatimit të të gjithave akteve ligjore në rastin e zjarreve masive dhe koordinimi i strukturave zjarrfikëse në nivel vendor.

8. **Partnerët ndërkombëtarë, OJQ-të dhe donatorët (donatorët)** – ky grup interesi ka luajtur një rol kyç që nga ngritja e sistemit të emergjencave civile në vitin 2001 në Shqipëri. Tre donatorët kryesorë, përkatësisht BE, BB dhe OKB, kanë ndihmuar Shqipërinë veçanërisht në përpjekjet e rimëkëmbjes pas fatkeqësive (përmbytjet e shpeshta dhe tërmeti i kohëve të fundit).

9. **Komiteti i Mbrojtjes Civile (KMC)** – roli potencial i rëndësishëm i KMC-së është përshkruar në ligjin 45/2019, si një strukturë rregullatore dhe e koordinimit të përgjithshëm.

10. **Shërbimi i Vullnetarëve për Mbrojtjen Civile (ShVMC)** – kjo është një strukturë vullnetare, e cila është në proces formimi dhe zhvillimi (krijuar në vitin 2013). Aktualisht, shërbimi është një strukturë e përgjigjes operacionale. Gjithashtu, ai ofron shërbime të urgjencës mjekësore me ambulanca gjatë një emergjence.

11.Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO) – një aktor i rëndësishëm në fushën e zhvillimit të njohurive dhe kuptimit mbi risqet ekzistuese dhe potenciale nga fatkeqësitë. IGJEO është identifikuar si struktura kombëtare e monitorimit dhe paralajmërimit për aktivitetin meteorologjik, hidrologjik dhe sizmologjik në Shqipëri. IGJEO është pjesë e Universitetit Politeknik të Tiranës dhe është nën varësinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. IGJEO ofron informacion për AKMC-në dhe agjencitë e tjera përmes "Qendrës Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Risqeve Natyrore" dhe Qendrës Kombëtare për Monitorimin e Aktivitetit Sizmik. Gjithashtu, ai jep informacione të vazhdueshme dhe bashkëpunon me struktura të tjera të emergjencave civile në nivel vendor në analizimin dhe monitorimin e situatës dhe në dhënien e informacioneve periodike.

12. **Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore (ShKUM)** – përgjegjës për zhvillimin e sistemit të shërbimit të urgjencës mjekësore nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të të gjitha aseteve ekzistuese në një sistem shtetëror të unifikuar. Ai funksionon bazuar në ligjin nr. 147/2014, "Për shërbimin e urgjencës mjekësore". Zvogëlimi dhe gatishmëria ndaj riskut nga fatkeqësitë janë elementë të rëndësishëm në misionin e këtij institucioni. Gjatë një emergjence, ky shërbim bëhet pjesë thelbësore e forcave operacionale dhe duhet të koordinojë veprimet me ta në mënyrë që të mundësojë një përgjigje efektive (bazuar në ligjin "Për mbrojtjen civile"). Gjithashtu, mund të japë informacione të dobishme për identifikimin e riskut nga fatkeqësitë, veçanërisht për sa i përket risqeve të lidhura me shëndetin dhe atyre biologjike.

13. **Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSh)** – Aktiviteti i KKSh-së bazohet në ligjin nr. 7864, datë 29.9.1994 "Për Kryqin e Kuq Shqiptar", i ndryshuar. Roli i KKSh-së në MRF është shumë
    i ngjashëm me atë të ShKUM-it. Në rastin e një emergjence civile, KKSh krijon qendra informacioni, realizon vlerësime të dëmeve dhe nevojave, ofron asistencë/shërbim psiko-social dhe të dhënies së ndihmës së parë, shpërndan paketa ushqimore dhe garanton kushte jetese normale për popullsinë e prekur.

14. **Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)** – angazhimi i këtij grupi interesi në sistemin e MRF-së është e lidhur kryesisht me menaxhimin e burimeve financiare, zbatimin e procedurave doganore ligjore, adresimin e nevojave të përgjigjes dhe rimëkëmbjes në subjektet private, infrastrukturën publike dhe kritike.. Megjithatë, është
    e rëndësishme të ndërtohet një vizion i qartë dhe të kuptohen specifikat e MRF-së brenda këtij institucioni për dy arsye kryesore. Së pari, është e rëndësishme që të integrohet në të gjithë sektorët e ekonomisë qasja e zhvillimit të bazuar në informacionet mbi riskun dhe, së dyti, MFE është një burim kryesor i mbështetjes financiare për sistemin e MRF-së, çka është thelbësore për ngritjen e përgjithshme të kapaciteteve dhe funksionimin efikas të këtij sistemi.

15. **Ministritë e linjës (ML)** – pothuajse të gjitha ministritë e linjës mund të angazhohen me efikasitet në sistemin e MRF-së. Megjithatë, MRF nuk është drejtpërdrejt pjesë e misionit të tyre, ose në rastin më të mirë, kufizohet në menaxhimin e riskut në fushën e tyre përkatëse të punës. Për rrjedhojë, aktualisht roli i tyre duket se është mjaft i kufizuar dhe ato angazhohen kryesisht në identifikimin e riskut përmes shkëmbimit të informacionit dhe komunikimit. Është e rëndësishme të identifikohen strategjitë e duhura për angazhimin më të mirë të ministrive në zhvillimin e sistemit të MRF-së dhe në integrimin e qasjes së MRF-së në të gjitha funksionet e tyre. Ministritë e linjës në vijim janë angazhuar në sistemin e MRF-së në Shqipëri:

    a. **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - MTM**
    b. **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - MIE**
    c. **Ministria e Arsimit dhe Sportit MAS**
    d. **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - MShMS**
    e. **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – MBZhR**

13. Përmbledhje e rekomandimeve kryesore.

Rekomandimet e dhëna në gjashtë raportet tematike janë në përputhje me temat e rëndësishme të identifikuara nga AKMC dhe grupet e tjera të interesit.

13.1 Zbutja e riskut nga fatkeqësitë.

- Zbutja e riskut nga fatkeqësitë duhet të jetë një komponent i një Strategjie të Integruar Kombëtare për Menaxhimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Masat e zbutjes duhet të zbatohen sipas kategorisë përkatëse dhe intensitetit të pranueshëm.
- Monitorimi është një aspekt thelbësor i zbutjes së ndikimit të mundshëm të rreziqeve nga fatkeqësitë. Metodat e përparuara të monitorimit dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm mundësojnë parashikime të sakta të ngjarjeve të ardhshme dhe mund të rrisin efikasitetin e masave parandaluese.
- Masat e zbutjes së **riskut nga përmbytjet** duhet të përcaktohen në kuadrin e përgjithshëm të Planeve të Menaxhimit të Rezervuarëvesi dhe investime ne diga, për të shmangur ndonjë fatkeqësi.
- Masat e zbutjes ndaj **riskut gravitacional** përfshijnë masat teknike, biologjike, si dhe planifikimin dhe zonimin e përshtatshëm hapësinor.

    - o Masat teknike mundësojnë mbrojtje aktive ndaj riskut të çarjes së digave, rrëshqitjeve të tokës dhe ortekëve. Ato ndikojnë në proceset natyrore për të shmangur ngjarjet ose për të kufizuar shtrirjen dhe intensitetin e tyre. Masat teknike duhet të zbatohen, monitorohen dhe ruhen në mënyrë të saktë për të garantuar funksionimin e duhur; Masat biologjike për zbutjen e riskut nga fatkeqësitë bazohen në pyjet dhe bimësinë e pranishme përgjatë shpateve të prekura. Mirëmbajtja e duhur e këtyre aseteve mundëson mbrojtje të shumëfishtë ndaj erozionit, rrokullisjes së shkëmbinjve, ortekëve dhe rrëshqitjeve. Pyjet mbrojtëse janë një ndër elementët qendrorë në zbutjen e rreziqeve gravitacionale. Pyjet mund të mbrojnë fshatra dhe infrastruktura të tëra nga rreziqet natyrore. Pyjet mbrojtëse duhet të ruhen dhe mbrohen në mënyrën e duhur pasi shpeshherë ndodhen në vendndodhje me rëndësi ekstreme.

    - o Mbrojtja e ndërtesave bazohet në përdorimin e tokës, planifikimin e tokës dhe ngritjen e ndërtesave të reja jashtë zonave të rrezikut. Ndërtesat e projektuara në mënyrë të posaçme në zonat e ekspozuara ndaj rreziqeve specifike do të zvogëlonin dëmin potencial. Projektimi, ndërtimi dhe materialet duhet të përshtaten sipas kushteve vendore dhe potencialit të ekspozimit.

- Zbutja e riskut nga **zjarret masive** duhet të nisë me përgatitjen e planit të detyrueshëm të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin e pyjeve/kullotave.
- Zvogëlimi në mënyrë efikase i riskut nga zjarret masive në zonat e mbrojtura dhe sipërfaqet e tjera të pyjeve/kullotave mund të përfshijë masa të tilla si, hapja e rrugëve të reja për të rritur aksesueshmërinë rrugore, hapja e korridoreve të reja kundër zjarreve masive, si dhe rrallimi i bimësisë dhe krijimi i hapësirave.
- Masat e zbutjes dhe parandalimit të zjarreve masive mund të përfshijnë gjithashtu ashpërsimin e kuadrit ligjor dhe miratimin e penaliteteve më të larta për zjarrvënien e qëllimshme. Këto mund të shoqërohen me rritjen e numrit të vlerësuesve të zjarreve masive gjatë sezoneve më të rrezikshme.

Duke iu referuar në mënyrë më specifike një prej sektorëve me një sërë **rreziqesh teknologjike,** si p.sh. minerar, hecet, pikave të rezervimit dhe tregtimit të hidrokarbureve si naftë, benxin,gazë, është e nevojshme që të vazhdohen studimet dhe vlerësimet mbi kushtet teknike-teknologjike të instalimeve dhe tubacioneve për , nxjerrjen, depozitimin, rafinimin dhe transportin e naftës,

gazit dhe nënprodukteve të tyre, me qëllim që të vlerësohet rreziku teknologjik që paraqesin ndaj ekonomisë, jetës së njerëzve, pronës dhe mjedisit.

- Pronarët e riskut në shumicën e rasteve janë subjektet private që veprojnë bazuar në licencat e qeverisë. Forcimi i sistemit të licencimit (legjislacioni, standardet e përdorura) dhe sistemi i pajtueshmërisë (inspektorate) detyron subjektet private të paraqesin vlerësimet përkatëse të riskut.

Disa prej risqeve mund të zvogëlohen ndjeshëm përmes politikave që ndajnë instalimet teknologjike me risk nga bartësit e riskut, si njerëzit që jetojnë në zonat përreth, atraksionet turistike dhe asetet e cenueshme mjedisore. Për shembull, përmes planifikimit të përdorimit të tokës dhe masave të tjera ligjore.

- Në mënyrë që veprimet të bazohen te vlerësimi i rreziqeve teknologjike dhe risqeve të lidhura me to, është e nevojshme që të planifikohen gjithashtu burimet financiare të nevojshme për të mundësuar një mbrojtje civile të integruar (jo thjesht burimet financiare për emergjencat). Duke pranuar faktin se këto burime financiare mund të konsiderohen relativisht të kufizuara në nivel qeveritar, qendror dhe vendor, mund të jetë e nevojshme përfshirja e Agjencive të Sigurimit në këtë proces, i cili do të duhet të adresojë çështjet dhe të gjejë zgjidhje bazuar në dokumentet kryesore, si vlerësimi i riskut dhe cenueshmërisë, strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe planet e veprimit (planet e emergjencës).

13.2 Ngritja e kapaciteteve për vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë.

- Hapi i parë në ngritjen e kapaciteteve për vlerësimin e ardhshëm të riskut nga fatkeqësitë në Shqipëri dhe në Bashkinë Has , duhet të jetë vazhdimi i popullimit të bazës së të dhënave DESINVENTAR dhe regjistrimi sistematik i dëmeve dhe humbjeve nga fatkeqësitë e ardhshme dhe ngjarjet e ngjashme.
- Përgatitja e metodologjisë dhe ngritja e kapaciteteve në nivel kombëtare dhe vendor për realizimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel bashkie.
- Ekziston një nevojë për të përmirësuar më tej krijimin dhe funksionimin e bazës së të dhënave për të gjitha fatkeqësitë në nivel kombëtar dhe vendor. Identifikimi i të dhënave, aksesi në to dhe përdorimi i tyre i mëtejshëm duhet të koordinohen me grupet e interesit në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Nevojitet përmirësimi i cilësisë së të dhënave të raportuara për fatkeqësitë dhe emergjencat në nivel vendor, qarku dhe qendror.
- Rekomandohet të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e Direktivës së BE-së "Për përmbytjet" dhe të procedurave për përgatitjen e Hartave të rrezikut dhe riskut nga përmbytjet, si dhe të Planeve të Menaxhimit të Riskut .
- Rekomandohet përgatitja e udhëzuesit teknik për vlerësimin e riskut të infrastrukturave kritike .
- Ekziston nevoja e përgatitjes së një metodologjie të re për vlerësimin e dëmeve nga zjarret masive, duke përfshirë humbjen e ekosistemit dhe dëmet e tjera mjedisore.
- Nevojitet fuqizimi i burimeve njerëzore, veçanërisht në vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë. Në raportet për rreziqet specifike janë dhënë rekomandime specifike mbi burimet njerëzore dhe kapacitetet teknike për secilin vlerësim tematik.
- Njohja e rreziqeve teknologjike në kuadër të qëllimit të vlerësimit dhe zvogëlimit të riskut teknologjik, kërkon trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të angazhuar në vlerësimin e riskut në nivel qendror dhe vendor, si dhe të stafit në subjektet që operojnë në sektorin industrial, të energjisë, transportit (të cilët janë gjithashtu pjesë e infrastrukturës kritike), si dhe të sektorit të ndërtimit

13.3 Hartimi i Strategjisë për MRF.

Rekomandimet për Strategjinë për MRF janë dhënë për nivelet qendrore dhe vendore.

Rekomandimet kryesore për **Strategjinë për MRF** përfshijnë:

- Të zhvillohet një metodologji dhe të krijohet një proces i përhershëm për realizimin e një vlerësimi të riskut në nivel vendor, në kuadër të planifikimit bashkiak për menaxhimin e riskut në nivel vendor.
- Të përgatitet një metodologji për menaxhimin e pyjeve (duke përfshirë menaxhimin e riskut nga zjarret masive), ku të jepen rekomandime të veçanta për zonat kombëtare të mbrojtura dhe zonat në pronësi të bashkive.
- Të zhvillohen dhe zbatohen Plane gjithëpërfshirëse për Menaxhimin e Riskut nga Përmbytjet në Basenet poshtë digave, për secilën prej zonave të identifikuara nga vlerësimi aktual i riskut nga fatkeqësitë.
- Të përshtatet dhe krijohet një qasje inovative për udhëheqjen e menaxhimit të riskut nga përmbytjet dhe thatësirat (Përgjigje "EPIC").

Të merret në konsideratë zhvillimi i programit kombëtar për vlerësimin e rrezikut sizmik, ku të përfshihet një monitorim i sigurt dhe i përhershëm i tërmetevë, përmes një rrjeti modern dhe të qëndrueshëm të stacioneve sizmologjike dhe lëkundjeve të forta, vlerësimi i pasojave të tyre në sipërfaqe, sjelljen e tokës së butë dhe infrastrukturën kritike

- Të merren në konsideratë rezultatet e vlerësimit të riskut për planifikimin e përdorimit të tokës dhe për zhvillimin e zonave të reja rezidenciale dhe industriale.
- Të garantohet mbështetje teknike dhe trajnim i burimeve njerëzore të Agjencisë Rajonale për Zonat e Mbrojtura (ARZM), me fokus kryesor në menaxhimin e zjarreve masive (duke përfshirë masat e përgatitjes, gatishmërisë, përgjigjes dhe rimëkëmbjes).
- Të forcohen më tej kapacitetet e sistemeve të informacionit gjeografik në AKMC dhe strukturat e tjera përkatëse me qëllim që të analizohet më mirë menaxhimi i riskut në nivel vendor, qarku dhe kombëtar.
- Të vazhdojë përditësimi dhe përmirësimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm për të gjitha fatkeqësitë madhore në vend.
- Të merret në konsideratë zhvillimi i strategjisë financiare për të garantuar zbatimin e duhur të Strategjisw Vendore dhe Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe të Planeve vendore të Veprimit.
- Të ndërmerren masa për të rritur ndërgjegjësimin mbi menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë të grupeve kryesore të interesit të sistemit të MRF-së në vend.
- Konsiderohet i nevojshëm vlerësimi i interesit të veçantë në kontekstin e zhvillimeve aktuale, situatës së rrezikut dhe riskut përkatës të lidhur me teknologjinë në infrastrukturën kritike dhe më specifikisht në atë energjetike, me qëllim që të zgjerohet objekti i vlerësimit të projektit për Vlerësimin e Riskut Teknologjik në territorin e bashkisë Has, duke përfshirë ndoshta edhe një projekt të veçantë për "Vlerësimin e Riskut të Infrastrukturës Kritike", duke u fokusuar tek infrastruktura energjetike dhe minerare.
- Shtrirja e vlerësimit të riskut teknologjik në risqet e shkaktuara nga transporti (rrugor dhe ajror)
- Rekomandimi gjithëpërfshirës, i cili ka si qëllim zvogëlimin, zbutjen dhe rrjedhimisht, parandalimin e burimeve kryesore të risqeve biologjike me të cilat po përballet aktualisht Shqipëria, është nevoja kritike për të investuar në mbikëqyrjen, parandalimin dhe edukimin mbi sëmundjet infektive. Kjo mund të arrihet përmes masave në vijim:

- Trajnimi i epidemiologëve dhe specialistëve të shëndetit publik dhe punësimi i tyre në sistemin e shëndetit publik të Shqipërisë dhe të Shëndetsisë Has.

- Publikimi i raporteve vjetore, të disponueshme për publikun, mbi të gjitha sëmundjet infektive në Shqipëri, në mënyrë të ngjashme me vendet e tjera, si për shembull të dhënat e disponueshme për publikun.

- Investimi në fushatat e vaksinimit dhe të shëndetit publik në mbarë vendin, duke përfshirë ngritjen e klinikave të vaksinimit në vendndodhje të përshtatshme, fushatat e vaksinimit në zona të largëta dhe vizitat në shtëpi, si dhe dhënien e informacionit në forma të ndryshme rreth sigurisë dhe nevojës kritike për vaksinim. Për secilin prej risqeve nga fatkeqësitë madhore, sipas rreziqeve.

Punoi:

Përgjegësi i Emergjencave Civile **Fatos Ahmati**

Inspektori i Emergjencave Civile **Besmir Cahani**

Konfirmoi:

Drejtoresha e Mbrojtjes Civile

ARBERIE RADA